



Lurimi Shpk

Bashkia Himarë

Relacioni i Planit të Mbarështimit të Ekonomisë Pyjore “Papadhi Çipin”

2026 - 2035

Raporti Final

MAJ 2026



BASHKIA HIMARË

Plani i Mbarështimit i Pyjeve dhe Kullotave të Ekonomisë pyjore “Papadhi Çipin” për periudhën 2026- 2035.

KONSULENTI “LURIMI”SHPK

Administrator

**(Ekspert për vegjetacionin dhe biodiversitetin)
(drejtues teknik i kompanisë)**

Inxh. Lutfi Miftari

Plani i mbarështimit u hartua nga ekspertë të kompanisë LURIMI shpk

Ekipi i konsulencës		
Ekspert kyç	Emër Mbiemër	Pozicioni
K-1	Vasillaq Mine	Statisticien pyjesh
K-2	Endri Bala	Ekspert GIS
K-3	Bibe Dodaj	Ekspert per terrenin
K-4	Lutfi Miftari	Ekspert per vegjetacionin dhe biodiversitetin
K-5	KLEDI LUFAJ	Ekspert ne pyje ,terreni pjese e grupit te punes

Kodi ALFIS:

Data e miratimit:

SHKURTESA

PMPK Plan i Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave

EP Ekonomi Pyjore

PM Plan Mbarështimi

NjA Njësi Administrative

MM Ministria e Mjedisit

AKP Agjencia Kombëtare e Pyjeve

Contents

I.	Hyrje	8
I.1	Qëllimi dhe objektivat e Planit të Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave	8
I.2	Ecuria e punës dhe përgjegjësitë	10
I.3	Metodologjia e punës	10
I.4	Informacioni i përdorur në përgatitjen e PMPK	11
II.	Përshkrim i përgjithshëm i bashkisë dhe Ekonomisë Pyjore Papadhi Çipin.	12
II.1	Informacion i përgjithshëm rreth Bashkisë dhe ekonomisë pyjore	12
	<i>Figura II.1.1 Teritori i bashkisë Himarë, me Njësitë Administrative</i>	16
II.2	Pronësia, administrimi dhe organizimi	17
II.3	Vendndodhja gjeografike dhe administrative	18
II.4	Konteksti i Bashkisë dhe Ekonomisë Pyjore	20
II.5	Historiku i Mbarështimit të pyjeve dhe kullotave në Ekonominë Pyjore	20
II.6	Situata demografike dhe socio-ekonomike	23
II.7	Tregtimi i prodhimeve pyjore drusore dhe jodrusore	25
II.8	Gjuetia dhe peshkimi	26
II.9	Infrastruktura rekreative dhe didaktike	30
II.10	Prania e siteve dhe specieve me vlera të larta mbrojtjeje	31
III.	Situata aktuale e pyjeve dhe kullotave	31
III.1	Mbarështimi dhe funksionet e pyjeve dhe kullotave	31
III.1.1	Përdorimi i territorit (aktual dhe propozimet)	31
III.1.2	Regjimi i qeverisjes (aktuale dhe propozimet)	32
III.1.3	Ndarja e Ekonomisë Pyjore në parcela dhe n/parcela	34
IV.	Përshkrimi i stacionit	35
IV.1	Klima	35
IV.2	Topografia dhe morfologjia	38
IV.3	Gjeologjia	41
IV.4	Tokat	42
IV.5	Rrjeti hidrologjik dhe burimet e furnizimit me ujë	45
IV.6	Erozioni në sipërfaqet e pjerrëta dhe rrjedhat ujore	45
IV.7	Rrëshqitjet e tokës	46
V.	Vegjetacioni dhe biodiversiteti	46

V.1	Brezat bio-klimatikë.....	46
V.2	Pyjet dhe kullotat	47
V.3	Tipet pyjore.....	48
V.4	Tipet e kullotave	49
V.5	Tipet e vegjetacionit potencial	50
V.6	Biodiversiteti.....	52
V.7	Prania e vlerave të larta mbrojtëse	53
V.8	Rreziku për biodiversitetin dhe efektet mbi planifikimin.....	53
V.9	Mundësitë për aktivitete didaktike dhe kërkimore.....	53
VI.	ANALIZIMI I TË DHËNAVE PËR PYJET DHE KULLOTAT.....	54
VI.1	Analizimi i të dhënave për pyjet.....	54
VI.1.1	Analizimi i tipeve pyjore	54
VI.1.2	Shpërndarja e sipërfaqes dhe volumit sipas regjimit të qeverisjes.....	55
VI.1.3	Struktura e pyjeve sipas klasave të moshës dhe klasave të prodhimtarisë së stacionit	58
VI.2	Analizimi i të dhënave për kullotat.....	66
VI.2.1	Gjendja e kullotave	66
VI.2.2	Madhësia dhe vendndodhja e sipërfaqes kullosore.....	67
VI.2.3	Altituda, pjerrësia, kundrejtimi dhe kushtet hidrologjike	67
VI.2.4	Mbërritshmëria	67
VI.2.5	Mbledhja e të dhënave për sipërfaqet e djegura në kullota.....	68
VII.	REZULTATET E INVENTARIZIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE	68
VII.1	Rezultati i inventarizimit në pyje	68
VII.1.1	Analiza statistikore e inventarizimit të pyjeve	68
VII.1.2	Volumi dhe rritja në volum e grumbujve pyjorë	70
VII.1.3	Struktura vertikale.....	70
VII.1.4	Cilësia e lëndës drusore në këmbë.....	73
VII.1.5	Biomasa dhe faktorët e ekspansionit të biomasës (BEF)	73
VII.1.6	Analiza e rolit të ekonomisë pyjore në sekuestrimin e Karbonit	74
VII.2	Gjendja shëndetësore/fitosanitare	75
VII.2.1	Drurët e tharë.....	75
VII.2.2	Dëmtime të tjera	75
VII.3	Prerjet e paligjshme.....	76

VII.3.1	Prerjet e paligjshme, gjendja aktuale dhe efektet ne procesin e planifikimit.....	76
VII.3.2	Impakti i prerjeve ilegale në planifikimin dhe mbarështimin e pyjeve	76
VII.4	Rezultatet e inventarizimit të kullotave	76
VII.4.1	Tipi dhe cilësia e kullotave.....	76
VII.4.2	Përdoruesit e kullotave dhe koha e përdorimit	77
VII.4.3	Numri aktual i blegtorisë	78
VII.4.4	Përdorimi aktual dhe kapaciteti mbajtës i kafshëve	78
VII.4.5	Infrastruktura aktuale.....	78
VII.4.6	Problemet për kullotjen dhe furnizimin me bazë ushqimore për bagëtitë.....	78
VIII.	Objektivat e planit të Mbarështimit të pyjeve dhe kullotave	79
VIII.1	Objektivat e përgjithshme për planifikimin afatgjatë	79
VIII.2	Objektivat kombëtare për zhvillimin e pyjeve dhe kullotave.....	79
VIII.3	Përputhshmëria e PMPK me Planifikimin Bashkiak dhe Rajonal.....	79
VIII.4	Objektivat kryesore të PMPK.....	80
VIII.5	Objektivat specifike për ekonominë pyjore/NjM	81
VIII.5.1	Objektivat specifike për përdorimin e tokës, funksionin dhe formën e qeverisjes	81
VIII.5.2	Objektivat specifike për tipet pyjore	81
VIII.5.3	Objektivat specifike silvikulturore	82
VIII.5.4	Objektivat specifike për kullotat.....	82
VIII.5.5	Objektivat specifike për biodiversitetin.....	82
VIII.5.6	Objektivat specifike për gjendjen shëndetësore	83
VIII.5.7	Objektivat specifike për faunën e egër.....	83
VIII.5.8	Objektivat specifike për pyjet me funksion prodhues.....	83
VIII.5.9	Objektivat specifike për pyjet me funksion mbrojtës	85
VIII.5.10	Objektivat specifike për pyjet me funksion rekreativ	85
VIII.5.11	Objektivat specifike për pyjet me status konserues.....	85
IX.	Masat e planifikimit / aktivitetet në kuadër të PMPK	85
IX.1	Prerja vjetore e lejuar/Mundësia vjetore e shfrytëzimit.....	85
IX.2	Prerjet silvikulturore vjetore	89
IX.3	Planifikimi vjetor i masave.....	90
IX.3.1	Masat në pyje	90
IX.3.2	Masat në kullota	91

IX.3.3	Masat në infrastrukturë dhe në sipërfaqet e degraduara, rekreative dhe didaktike	91
IX.4	Masat afatgjata.....	91
IX.4.1	Masat silvikulturore në pyjet trugishte	91
IX.4.2	Masat silvikulturore në pyjet cungishte	96
IX.4.3	Masat silvikulturore në shkurre.....	97
IX.4.4	Pyllëzimet dhe ripyllëzimet	97
IX.4.5	Masat e aplikuara në kullota	97
IX.4.6	Gjendja dhe masat në infrastrukturën e EP	97
IX.4.7	Masat specifike për aktivitetet rekreative dhe didaktike.....	98
X.	Vlerësimi ekonomik.....	98
X.1	Vlerësimi i ndikimeve të masave të planifikuara mbi pyjet dhe kullotat	98
X.2	Planifikimi i të ardhurave / përfitimeve	99
X.3	Planifikimi i shpenzimeve	100
X.4	Analiza shpenzime – përfitim	100
ANEKSI nr.1	Të dhëna të përgjithshme mbi ekonominë pyjore.....	101

I. Hyrje

I.1 Qëllimi dhe objektivat e Planit të Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave

Në kuadër të hartimit të planit të menaxhimit për ekonominë pyjore Papadhi Çipin, u bë mëse e domosdoshme njohja e gjendjes reale të pyjeve.

Ky plan Mbarështimi për ekonominë pyjore Papadhi Çipin, bëhet i mundur në sajë të financimit, të mundësuar nga buxheti i Bashkisë Himarë.

Njohja e gjendjes së pyjeve, përcaktimi dhe vlerësimi aktual dhe në perspektivë i potencialit prodhues dhe i mjaft funksioneve të tjera që ofron pylli, arrihet nëpërmjet mbarështrimeve periodike (çdo 10 vjet). I njohur si element i domosdoshëm për të përcaktuar qartë se si është gjendja aktuale e pyllit, ku duam t'a shpiem atë. Mbarështimi paraqet rëndësinë e tij të pa zëvendësueshme dhe bëhet bashkëudhëtar jetik i pyjeve të trajtuar, në vecanti. Për këtë qëllim, duke parë edhe kohën e gjatë që ka kaluar si dhe ndryshimet drastike që kanë pësuar sipërfaqet pyjore të vendit tonë gjatë kësaj periudhe (të ashtuquajtur tranzicion) u bë i domosdoshëm edhe Mbarështimi i ekonomisë pyjore "Papadhi Çipin".

Ekonomia pyjore "Papadhi Çipin", është mbarështruar për herë të fundit në vitin 1985. Mbarështimi i saj është mundësuar nga stafi teknik i ish Ndërmarrjes Pyjore të rrethit Vlorë. Që nga ajo kohë e deri më sot kanë kaluar afro 40 vjet, në të cilat kjo ekonomi pyjore, ka pësuar ndryshime të mëdha dhe mjaft të ndjeshme, si përsa i përket strukturës ashtu dhe shpërndarjes së vëllimit sipas klasave të moshës dhe prodhimit. Prandaj duke u nisur nga këto arsye dhe, njëkohësisht duke vlerësuar punën e bërë për hartimin e planit të pararendës, u pa e arsyeshme dhe e domosdoshme hartimi i këtij plani të ri Mbarështimi, i cili pasqyron gjëndjen reale të grumbujve, duke i parë në këndvështrime të ndryshme si ajo e prodhimtarisë, e ruajtjes së biodiversitetit dhe garantimin e periodicitetit ciklik të qëndrueshëm të vjeljes së materialeve drusore dhe të mirave që ofron pylli.

Plani i Mbarështimit të kësaj ekonomie është hartuar duke u mbështetur plotësisht në *Udhëzuesin e Planeve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave të vitit 2019*, të miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit me shkresën nr. 834. Ndërsa përpunimi i të dhënave është bërë sipas programit të punimeve të zyrës të hartuar me ndihmën e FAO dhe miratuar nga ish D.P.P.K.

Objektivat e Mbarështimit janë hartuar e ideuar në bashkëpunim me stafin e speciaistëve të Shërbimit Pyjor, popullatat lokale dhe me organet e Pushtetit Vendor. Ato kanë konsistuar ne:

- Arritjen e normalitetit të grumbujve pyjorë, me qëllim garantimin e zhvillimit të qëndrueshëm për të dhënë një prodhim maksimal duke siguruar një nivel të lartë të të ardhurash dhe nivel të lartë funksionimi të ekosistemit pyjor.
- Sigurimi i shumëfunksionalitetit të pyllit për ruajtjen e biodiversitetit dhe shtimit të të ardhurave në dobi të popullatave lokale të zonës ku shtrihet ekonomia pyjore Papadhi Çipin.
- Intensifikimi i rritjes natyrore të grumbujve, nëpërmjet ndërhyrjeve silvikulturale, sidomos në cungishtet e degraduara të kësaj ekonomie, duke synuar në të njëjtën kohë edhe përmirësimin e strukturës së klasave të moshës.
- Shtimi i sipërfaqes së mbulesës pyjore dhe sigurimi i vazhdimësisë së ripërtëritjes natyrore.
- Përmirësimi i strukturës llojore dhe dhënia prioritet llojeve natyrore që arrijnë të fitojnë maksimumin e potencialit ekologjik të zonës.

- Përmirësim i mëtejshëm i shërbimit me rrugë auto të ekonomisë nëpërmjet meremetimit dhe mirëmbajtjes së rrjetit rrugor aktual dhe hapjes së segmenteve të rinj aty ku është i nevojshëm, me qëllim shërbimin në kohë e me cilësi të nevojave që paraqet pylli, dhe në të njëjtën kohë për qëllime rekreative e shumë funksionale.

Në këtë plan Mbarështimi një vëmendje e veçantë i është kushtuar politikave të planifikimit, për të patur një Mbarështimi të qëndrueshëm dhe shumë funksional të pyllit. Është synuar të arrihet realisht potenciali prodhues i pyjeve duke mbrojtur biodiversitetin dhe mjedisin në tërësi.

I.2 Ecuria e punës dhe përgjegjësitë

Pas firmosjes së kontratës puna filloi me grumbullimin e dokumentave të nevojshëm për hartimin e planit të mbarështimit si: planin e vjetër të inventarizimit, hartat e ekonomisë pyjore, studimet e mëparshme si:

Plani i zhvillimit Vendor i Bashkisë Himarë dhe dokumentat që lidhen me aspektin ligjor në fushën e pyjeve si:



Përgjegjësia për kryerjen e punimeve të terrenit dhe hartimin e planit të mbarështimit ka qenë e kompanisë **Lurimi shpk**. Eksperti GIS pasi ndërtoi hartën pyjore të ngastrave dhe nengastrave pyjore ndërtoi rrjetin e sipërfaqeve prove i cili u pasqyrua në harte dhe në ortofoto dhe me pas pikat e këtij rrjeti u hodhën në GPS ku me pas filloi puna e terrenit e cila zgjati për një periudhë 90 ditore. Pas përfundimit të matjeve në terren puna vazhdoi me përpunimin e të dhënave dhe me shkrimin e raportit të planit të mbarështimit.

I.3 Metodologjia e punës

U zbatua një metodologji nëpërputhje të plotë me përshkrimet në *Udhëzuesin e Planeve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave të vitit 2019*, të miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit me shkresën nr. 834.

Është thelbësore që të lidhet analiza e burimeve pyjore dhe kullosore me vizionin lokal të shprehur përmes takimeve me palët e interesuara. Qëllimi është gjetja e ekuilibrit të duhur midis kapaciteteve të burimeve pyjore-kullosore dhe pritshmërive të përdoruesve, në përputhje me rregulloret për një mbarështim të qëndrueshëm dhe shumëfunksional.

Ndërtimi i hartave të punës në terren nga eksperti i GIS, shërbeu si pikë nisje për inventarizimin e grumbullit në terren. Punimet e terrenit janë mbështetur në Udhëzuesin e miratuar për këtë qëllim. Kështu, pas gjetjes së pikës nëpërmjet pajisjes GPS, është materializuar qendra e sipërfaqes provë (SP) me një shufër hekuri me $\phi = 10$ mm dhe gjatësi 250 mm. Qendra e SP është referuar në objekte të tjera të qëndrueshme, për lehtësi të identifikimit në çdo kohë, duke përdorur bojë dhe duke dhënë distancat reale të shenjës nga qendra.

Më pas, janë hedhur të dhënat identifikuese në skeden e inventarizimit të SP dhe ka filluar puna për matjet. Në funksion të gjendjes së SP, matjet janë mbështetur në sipërfaqe provë bashkëkoncentrike me madhësi: 25 m², 200 m² dhe 400 m².

Për çdo dru është matur diametri në lartësinë e gjoksit (1.3 m nga toka) dhe në çdo katër drurë është matur lartësia e drurit përkatës. Numërimi i drurëve dhe matjet përkatëse kanë filluar prej drurit të pozicionuar në 0° shmangie nga poli i Veriut, duke u rrotulluar në sensin orar nga qendra e SP.

Pas përfundimit të matjeve, është kontrolluar skeda për ndonjë mangësi dhe ka vijuar më tej puna për matjet në terren.

Gjatë lëvizjes në terren, janë kryer edhe përshkrimet parcelare për secilën njësi unike të krijuar (nënparcelë), duke marrë të dhëna direkte bazuar në situatën aktuale të terrenit.

Gjatë kryerjes së punimeve të terrenit, ekipi i kompanisë Lurimi ka patur kontakte të vazhdueshme me stafin e pyjeve të bashkisë Himarë si dhe me banorët Nj.A. Horë Vranisht. Gjatë takimeve janë shkëmbyer mendime dhe janë informuar pronarët për punën e kryer në vijimësi.

I.4 Informacioni i përdorur në përgatitjen e PMPK

Krahas informacionit të mbledhur gjatë inventarizimit në terren dhe procesit me pjesmarrje, informacioni specifik që ishte i domosdoshëm të sigurohej në nivelin e Bashkisë Himarë në fillim të aktiviteteve ishte:

- Ndarjet parcelare dhe n/parcelare për EP Papadhi Çipin sipas kadastrës dhe AIFIS;
- Plani i mëparshëm i Inventarizimit të EP Papadhi Çipin, ai i vitit 1985.
- Te dhëna demografike sipas fshatrave brenda territorit të ekonomisë pyjore
- Aktivitete të lidhura me prodhimet drusore dhe jodrusore nga pyjet dhe kullotat;
- Rrugët dhe infrastruktura pyjore;

- Të dhëna historike mbi zjarret në pyje dhe rreziqet natyrore (rrëshqitjet e tokës, përmbytjet, stuhitë, tharjet e drurëve);
- Rrjeti hidrologjik dhe burimet e furnizimit me ujë;
- Prania e aktiviteteve edukative dhe didaktike lidhur me pyjet dhe kullotat;
- Prania e aktiviteteve turistike lidhur me pyjet dhe kullotat;
- Prania e siteve me vlera të larta mbrojtjeje. Kjo përfshin rezervatet farore, habitatet e veçanta (liqene, pyje të brigjeve të lumenjve...), site të njohura për vlerat kulturore, peizazhe të mbrojtura.;



- Prania e aktiviteteve kërkimore në pyje dhe kullota.
- Plani i vjetër i mbarështimit të kësaj ekonomie është përdorur për të marrë toponimet e vjetra të cdo n/ngastre dhe kryesisht për informacionin historik të kësaj ekonomie.

II. Përshkrim i përgjithshëm i bashkisë dhe Ekonomisë Pyjore Papadhi Çipin.

II.1 Informacion i përgjithshëm rreth Bashkisë dhe ekonomisë pyjore

EP Papadhi Çipin, shtrihet në shpatet e maleve me të njëjtin emër dhe me një numër të konsiderueshëm basenesh e mikrobasenesh ujëmbledhës.

Emërtimi i ekonomisë vjen nga bashkimi i emrave të dy maleve, përkatësisht Çipin dhe Papadhi të vendosur në dy skajet e EP dhe njihen si të tillë nga vendasit.

Kjo EP karakterizohet nga kufij natyrorë qartësisht të dallueshëm. Në tre anët e saj kufizohet nga rrjedha ujore, përrenj ose lumenj dhe në një anë kufizohet nga maja e kreshtandër kufijtë me karakteristik të kesaj EP përmendim:

Në Veri – Përroi i Bardhëdhe ai i zi që fillon nga derdhja e tij në lumin Shushicë, vazhdon gjatë shtratit ku bashkohen të dy përrenjtë, pastaj me shtratin e përroit të zinë drejtim të burimit të përroit deri në majën e Çipinit të Smokthinës me kuotë 1599 m mbi nivel deti.

Në Lindje – Maja e Çipinit të Madh me kuotë 1599m, në qafën e Kashtësme kuotë 1237 m, ngjitet në Majën e Gjatë me kuotë 1315m, në qafën e pishës 1387 m, në Majën e Begës në kuotën 695 m, zbret sërish në majën e Çipinit të Bolenës 1651 m për tu ngjitur sërish në majën e Pleshevicës 1733m dhe në majën e Maceve 1700m.

Në Jug – Fillon nga kuota 898m, ngjitet në majën e Kodrës 1391 m, vijon për kurrizi drejt kuotës 468 m, ndërpret rrugën auto Vlorë – Sarandë – qafë Drrasë në kuotën 432 m

Në Perëndim - Nis aty ku përroi i Thatë bashkohet me shtratin e lumit Shushicë, i cili kufizon thuajse 100% të gjithë anën perëndimore të EP, duke kaluar nga ura e Laskës, Ura e Mehmetit në kuotë 254 m dhe deri në përroin e Bolenës në kuotën 240 m.

Pavarësisht mikrobaseneve që formohen në brendësi të EP, theksojmë se baseni ujëmbledhës kryesor është ai i lumit Shushicë.

EP Papadhi Çipin shtrihet ndërmjet gjërësisë gjeografike $19^{\circ}41'10''$ – $19^{\circ}58'20''$ dhe gjatësi gjeografike $40^{\circ}07'50''$ – $40^{\circ}18'20''$.

Ajo është pjesë e hartave topografike me shkallën 1:25000

1. K – 34 – 136 – A – b (Brataj)
2. K – 34 – 136 – A – d (Vranishti)
3. K – 34 – 136 – B – a (Vermiku)
4. K – 34 – 136 – B – c (Kuçi)
5. K – 34 – 136 – D – a (Kudhësi)
6. K – 34 – 136 – D – b (Fushë Bardhë)

Sa i takon shtrirjes në kufijtë natyrorë, EP Papadhi Çipin kufizohet me Sarandën, Tepelenën dhe Vlorën.

Ajo kufizon në lindje në të gjithë gjatësinë e saj me EP Çipin deri në Majën e Maceve në kuotën 1700.3 m dhe më pas nga kjo kuotë kufizon me Bashkinë Tepelenë.

Në Jug ajo kufizon në të gjithë gjatësinë e saj me Bashkinë Sarandë. m dhe më pas nga kjo kuotë kufizon me Bashkinë Tepelenë.

Në perëndim kufizon e gjitha me EP Mali i Pilurit-Çikë me kufi natyral midis dy ekonomive lumin Shushicë.

Në veri kufi natyral i Ekonomisë është Përroi i Zi, i cili e ndan edhe me EP Çipin sa i takon pjesës veriore të saj.

Sipërfaqja e përgjithshme e Ekonomisë Pyjore Papadhi Çipin në të gjithë konturin e saj në këtë plan mbarështimi është gjetur 8658 ha. ***Theksojmë se sipërfaqja prej 1827 ha, pavarësisht se ndodhet brenda konturit të EP Papadhi Çipin, ajo nuk është përfshirë asnjëherë në regjistrat kadastral të saj, as në mbarështimin e fundit të vitit 1985, e për pasojë kjo sipërfaqe nuk është as pjesë e VKM së transferimit. Për lehtësi të paraqitjes hartografike dhe mbylljes së konturit të***

përgjithshëm të Ekonomisë Pyjore, kjo është sipërfaqe është shënuar në hartë me numrat rendor vijues përkatësisht:

Parcela 164 me sipërfaqe të përgjithshme 1480.9 ha

Parcela 165 me sipërfaqe 26.5 ha

Parcela 166 me sipërfaqe 50.9 ha

Parcela 167 me sipërfaqe 268.8 ha.

Kjo sipërfaqe është në përgjithësi, toka bujqësore dhe zona banimi dhe në disa raste veçanërisht në ish tokat frutikulturë është rikthyer edhe vegjetacioni natyral, pas braktisjes së këtyre sipërfaqeve.

Theksojmë se asnjëri nga numrat e mësipërme të këtyre parcelave nuk është shënuar dhe as regjistruar në programin Access BD.

Sipërfaqja totale e EP Papadhi Çipin, e përfshirë në këtë plan mbarështimi në përputhje me VKM e transferimit është 6858 ha.

Nga kjo janë gjetur:

- Sipërfaqe pyjore 4292 ha
- Sipërfaqe me bimësi pyjore 849.1 ha
- Kullota 1252 ha
- Jo-prodhuese 380.8 ha
- Djerr 5.4 ha

Që të gjitha format e përdorimit sa më sipër janë në pronësi të bashkisë Himarë, ndërsa brenda konturit të ekonomisë bëjnë pjesë edhe format e ërdorimit me pronësi private si:

- Toka bujqësore 70.8 ha
- Zona banimi (troje) 7.6 ha

Në formë tabelare dhe diagrami të dhënat e mëposhtme paraqitën në tabelën nr. 2.1, më poshtë. Theksojmë se kjo tabelë është produkt i përpunimit të të dhënave me programin Access DB.

<u>Perd.teritorit</u>	<u>Aktuale</u> <u>Siperfaqja ha</u>	<u>E propozuar</u> <u>Siperfaqja ha</u>
Total		
Pyll	4292.0	4292.0
Sip.me bim. pyjore	849.1	849.1
Bujqesi	70.8	70.8
Kullote, Livadh	1252.3	1252.3
Urbane	7.6	7.6
Ujore	0.0	0.0
Kenete, Mocal	0.0	0.0
Djerr	5.4	5.4
Joproductive	380.8	380.8
Total:	6858.0	6858.0

perd terit aktual

perd terit propozuar

Tabela 2.1. Të dhëna mbi përdorimin e territorit të gjetura në planin e mbarështimit aktual të EP Papadhi Çipin.

Sa i takon lidhjes me qendrat e banuara, theksojmë se, EP Papadhi Çipin tashmë në të gjithë konturin e saj lindor përshkruhet nga rruga që lidh Bypasin e Vlorës me Himarën, përgjatë lumit të Shushicës (lumit të Vlorës). Kjo rrugë i ka krijuar EP avantazhe në mbërritshmërinë e saj, duke shkurtuar distancat e transportit dhe duke ulur kostot e produkteve që dalin nga ajo.

E gjithë EP Papadhi Çipin është pjesë territoriale e Bashkisë Himarë dhe ndodhet në konturet territoriale administrative të NJ. A. Horë Vranisht.

Duke mbajtur si referencë që planet e mbarështimit hartohen me pjesëmarrje, banorët dhe zyrtarë nga Bashkia Himarë dhe NJ.A Horë Vranisht janë përfshirë në takimet e përbashkëta para dhe gjatë hartimit të këtij plani mbarështimi.

Më poshtë japim të dhëna të rëndësishme në lidhje me bashkinë Himarë, Njësitë e saj Administrative, popullsinë sipas censusit dhe të tjera.




Figura II.1.1 Teritori i bashkisë Himarë, me Njësitë Administrative

PROFILI I BASHKISË

Zona Gjeografike: Bashkia e Himarës kufizohet në veri me bashkitë Vlorë dhe Selenicë, në lindje me bashkitë Tepelenë, Gjirokastrë dhe Delvinë, në jug me bashkinë Sarandë dhe në lindje me detin Jon. Kryeqendra e Bashkisë është Himara.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011 Himara ka 7,818 banorë, ndërsa sipas Regjistrimit Civil kjo bashki numëron 27,049 banorë. Me sipërfaqe prej 571.94 km², densiteti i popullsisë në bazë të censurit rezulton vetëm 13.7 banorë/km² ndërsa sipas regjistrimit civil, densiteti është 47 banorë/km².

Të dhëna të tjera: Himara është një bashki që shtrihet përgjatë të gjithë bregut të Jonit si dhe në malet e Labërisë në pjesën e ish-komunës HorëVranisht. Ajo është një bashki e pasur me burime ekonomike me përqendrim të turizmit, peshkimit, blegtorisë dhe ullishtit, të gjitha produktet dhe shërbimet me vlerë të lartë të shtuar. Por pavarësisht kësaj, kjo do të jetë bashkia e dytë me densitetin më të ulët të popullsisë në Shqipëri pas Dropullit si pasojë e largimit të pjesës dërrmuese të banorëve për në Greqi ose në qendrat e mëdha urbane në vend. Bashkia e re ndahet në dy teritore shumë të ndryshme: zona bregdetare si dhe zona e ish-komunës Horë-Vranisht, një zonë e thyer malore e cila aktualisht nuk lidhet me qendrën e bashkisë me rrugë moderne të drejtpërdrejta, por vetëm me një rrugë historike mushkash e cila aktualisht nuk është e përdorshme.

Bashkia e ka mundësi të konsiderueshme ekonomike dhe në përgjithësi infrastrukturë të zhvilluar në drejtim të rrugëve dhe ujit të pijshëm ndërsa bregdeti i saj konsiderohet nga më të pastrit në vend për shkak të distancës së banesave nga bregu i detit. Ndërkohë, resurset bujqësore dhe blegtorale të zonës janë shumë pak të shfrytëzuara për shkak të largimit masiv të popullsisë apo tërheqjes së popullsisë së mbetur në aktivitete me më shumë të ardhura si turizmi.

II.2 Pronësia, administrimi dhe organizimi

Pronësia: Pronësia e EP Papadhi Çipin në fomat e përdorimit, pyll, kullota, sipërfaqe me bimësi pyjore, djerre dhe sipërfaqe joproduhuese (joproduktive) është 100% në pronësi publike dhe në administrim të bashkisë.

Ndërsa sipërfaqet me formë përdorimi zona të banuara (troje dhe të tjera zona urbane) dhe toka bujqësore të cilat ndodhen brenda konturit dhe njëkohësisht brenda parcelave apo n/parcelave pyjore, janë më pronësi private dhe administrohen nga pronarët e tyre.

Ekonomia pyjore Papadhi Çipin, administrohet nga Bashkia Himarë, nëpërmjet Sektorit të Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave i cili është pjesë integrale e Drejtorisë së Bujqësisë, Pyjeve, Kullotave dhe Ujitjes.

Format e pronësisë të gjendura në këtë plan mbarështimi për EP Papadhi Çipin jepen në tabelën në vijim.

PERDORIMI I TERITORIT

Perd.teritorit	Aktuale	E propozuar
	Sipërfaqja ha	Sipërfaqja ha

Ekonomia : EP Papadhi-Çipin

<i>Bashkiake</i>		
Pvll	4292.0	4292.0
Sip.me bim. pyjore	849.1	849.1
Bujqesi	0.0	0.0
Kullote, Livadh	1252.3	1252.3
Urbane	0.0	0.0
Ujore	0.0	0.0
Kenete, Mocal	0.0	0.0
Djerr	5.4	5.4
Joproduktive	380.8	380.8
Total:	6779.6	6779.6
<i>Private</i>		
Pvll	0.0	0.0
Sip.me bim. pyjore	0.0	0.0
Bujqesi	70.8	70.8
Kullote, Livadh	0.0	0.0
Urbane	7.6	7.6
Ujore	0.0	0.0
Kenete, Mocal	0.0	0.0
Djerr	0.0	0.0
Joproduktive	0.0	0.0
Total:	78.4	78.4

<u>Perd.teritorit</u>	<u>Aktuale</u> <u>Siperfaqja ha</u>	<u>E propozuar</u> <u>Siperfaqja ha</u>
Total		
Pyll	4292.0	4292.0
Sip.me bim. pyjore	849.1	849.1
Bujqesi	70.8	70.8
Kullote, Livadh	1252.3	1252.3
Urbane	7.6	7.6
Ujore	0.0	0.0
Kenete, Mocal	0.0	0.0
Djerr	5.4	5.4
Joproductive	380.8	380.8
Total:	6858.0	6858.0

perd terit aktual

perd terit propozuar

Tabela nr. 2.2. Të dhëna mbi përdorimin e territorit dhe pronësinë mbi EP Papadhi Çipin.

Administrimi: Pavarësisht pronësisë, administrimi i pyjeve dhe kullotave bëhet në përputhje me ligjin 57/2020, datë 30.04.2020 "Për pyjet", i ndryshuar dhe ligjin 8963, "Për fondin kullosor", i ndryshuar. Administrimi i fondit pyjor dhe kullosor brenda konturit territorial administrativ të Bashkisë Himarë, kryhet nga struktura përgjegjëse e kësaj bashkie.

Organizimi: Strukturat përgjegjëse që administrojnë fondin pyjor dhe kullosor të Bashkisë Himarë, janë të organizuara në bazë drejtorie. Struktura është miratuar me Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë Nr. 2, datë 31.01.2025, dhe sipas organigramës, strukturat përgjegjëse për administrimin e fondit pyjor dhe kullosor bëjnë pjesë në Drejtorinë e Bujqësisë, Pyjeve, Kullotave e Ujitjes. Brenda kësaj drejtorie janë dy sektorë përgjegjës për administrimin e kontrollin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore, përkatësisht:

- Sektori i Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave me 9 punonjës në total dhe
- Sektori i Kontrollit dhe Inspektimit të pyjeve dhe Kullotave me 3 punonjës gjithsej.

II.3 Vendndodhja gjeografike dhe administrative

EP Papadhi Çipin, është pjesë territoriale administrative e bashkisë Himarë. Ajo bën pjesë në basenin ujëmbledhës të lumit Shushicë.

EP Papadhi Çipin, shtrihet në shpatet e maleve me të njëjtin emër dhe me një numër të konsiderueshëm basenesh e mikrobasenesh ujëmbledhës.

Emërtimi i ekonomisë vjen nga bashkimi i emrave të dy maleve, përkatësisht Çipin dhe Papadhi të vendosur në dy skajet e EP dhe njihen si të tillë nga vendasit.

Kjo EP karakterizohet nga kufij natyrorë qartësisht të dallueshëm. Në tre anët e saj kufizohet nga rrjedha ujore, përrenj ose lumenj dhe në një anë kufizohet nga maja e kreshtandër kufijtë më karakteristik të kesaj EP përmendim:

Në Veri – Përroi i Bardhëdhe ai i zi që fillon nga derdhja e tij në lumin Shushicë, vazhdon gjatë shtratit deri ku bashkohen të dy përrenjtë, pastaj me shtratin e përroit të zinë drejtim të burimit të përroit deri në majën e Çipinit të Smokthinës me kuotë 1599 m mbi nivel deti.

Në Lindje – Maja e Çipinit të Madh me kuotë 1599m, në qafën e Kashtësme kuotë 1237 m, ngjitet në Majën e Gjatë me kuotë 1315m, në qafën e pishës 1387 m, në Majën e Begës në kuotën 695 m, zbret sërish në majën e Çipinit të Bolenës 1651 m për tu ngjitur sërish në majën e Pleshevicës 1733m dhe në majën e Maceve 1700m.

Në Jug – Fillon nga kuota 898m, ngjitet në majën e Kodrës 1391 m, vijon për kurri drejt kuotës 468 m, ndërpret rrugën auto Vlorë – Sarandë – qafë Drrasë në kuotën 432 m

Në Perëndim - Nis aty ku përroi i Thatë bashkohet me shtratin e lumit Shushicë, i cili kufizon thuajse 100% të gjithë anën perëndimore të EP, duke kaluar nga ura e Laskës, Ura e Mehmetit në kuotë 254 m dhe deri në përroin e Bolenës në kuotën 240 m.

Pavarësisht mikrobaseneve që formohen në brendësi të EP, theksojmë se baseni ujëmbledhës kryesor është ai i lumit Shushicë.

EP Papadhi Çipin shtrihet ndërmjet gjërësisë gjeografike 19°41'10" – 19°58'20" dhe gjatësi gjeografike 40°07'50" – 40°18'20".

Ajo është pjesë e hartave topografike me shkallën 1:25000

1. K – 34 – 136 – A – b (Brataj)
2. K – 34 – 136 – A – d (Vranishti)
3. K – 34 – 136 – B – a (Vermiku)
4. K – 34 – 136 – B – c (Kuçi)
5. K – 34 – 136 – D – a (Kudhësi)
6. K – 34 – 136 – D – b (Fushë Bardhë)

Sa i takon shtrirjes në kufijtë natyrorë, EP Papadhi Çipin kufizohet me Sarandën, Tepelenën dhe Vlorën.

Ajo kufizon në lindje në të gjithë gjatësinë e saj me EP Çipin deri në Majën e Maceve në kuotën 1700.3 m dhe më pas nga kjo kuota kufizon me Bashkinë Tepelenë.

Në Jug ajo kufizon në të gjithë gjatësinë e saj me Bashkinë Sarandë. m dhe më pas nga kjo kuota kufizon me Bashkinë Tepelenë.

Në perëndim kufizon e gjitha me EP Mali i Pilurit-Çikë me kufi natyral midis dy ekonomive lumin Shushicë.

Në veri kufi natyral i Ekonomisë është Përroi i Zi, i cili e ndan edhe me EP Çipin sa i takon pjesës veriore të saj.

II.4 Konteksti i Bashkisë dhe Ekonomisë Pyjore

EP Papadhi Çipin shtrihet në pjesën veriperëndimore të qytetit të Himarës në një distancë prej 24.7 km, tashmë prej 2021 rrugë të asfaltuara dhe me standarte. Rruga e cila kalon nëpër këtë EP pyjore lidh Bypasin e Vlorës me Palasën duke kaluar përgjatë brigjeve të lumit Shushicë.

Himara është një bashki që shtrihet përgjatë të gjithë bregut të Jonit si dhe në malet e Labërisë në pjesën e ish-komunës Horë-Vranisht. Një bashki e pasur me burime ekonomike me përqendrim te turizmi, peshkimi, blegtoria dhe ullishtet. Bashkia e re ndahet në dy territore shumë të ndryshme: Zona bregdetare si dhe Zona e ish-komunës Horë-Vranisht, një zonë e thyer malore e cila aktualisht nuk lidhet me qendrën e Bashkisë me rrugë moderne të drejtpërdrejtë, por vetëm me një rrugë historike mushkash e cila aktualisht nuk është e përdorshme. Bashkia e Himarës përveç burimeve të mëdha të turizmit detar disponon resurse të mëdha edhe në turizmin kulturor apo të natyrës.

Resurset bujqësore dhe blegtorale të zonës janë shumë pak të shfrytëzuara për shkak të largimit masiv të popullsisë apo tërheqjes së popullsisë së mbetur në aktivitete me më shumë të ardhura si turizmi.

Ne mbarë krahinën e Himarës mbisundon klima Mesdhetare. Nga verilindja vargu i Karaburunit dhe i Çikës (malet Akrokeravne) e mbrojnë ate nga murlani dimëror. Me këtë pozicion klimaterik krahina e Himarës, në tërësi me toka të pakta bujqësore, ka kultivuar kurdoherë, përveç blegtorisë, dy kulturat kryesore mesdhetare: ullinjtë dhe agrumet, pa përjashtuar vreshtat. Pozicioni gjeografik i ka detyruar banorët e krahinës të lidhen nga pikëpamja ekonomike jo vetëm me tokën, por edhe me .

Himara ndodhet ne faqen e vargmalit te Cikes dhe peisazhi i saj karakterizohet nga kurrizi ujendares dhe erozioni i kreshtes. Perceptimi eshte qe mali ndodhet larg bregut te detit dhe vija bregdetare zgjerohet dhe gradualisht kalon nepermjet disa luginave,kodrave dhe qepeve te vegjel.

II.5 Historiku i Mbarështimit të pyjeve dhe kullotave në Ekonominë Pyjore

Ekononima pyjore Papadhi Çipin, është mbarështuar për herë të fundit në vitin 1985 nga ish stafi inxhiniero-teknik i Ndërmarrjes Pyjore të rrethit të Vlorës.

Në përgjithësi, ekonomia pyjore Papadhi Çipin, ka shërbyer për sigurimin e lëndës drusore, si për lëndë punimi ashtu edhe për dru zjarri. Është karakterizuar, nga një prodhimtari e lartë dhe sigurim të lëndës drusore, kryesisht dru zjarri dhe kryesisht lënda e siguruar nga shfrytëzimi i

makies dhe dushqeve. Sipas planit të Mbarështimit të vitit 1985, Ekonomia Pyjore Papadhi Çipin, rezulton me një sipërfaqe të përgjithshme prej 6600 ha, e kategorizuar kjo në **5545.89 ha sipërfaqe pyjore**, ku nga kjo 2069.39 ha, janë pyje trungishte, 120.25 ha janë pyje cungishte dhe shkurret zënin 3357.25 ha.

Ndërsa diferenca tjetër prej 1054 .39 ha, kategorizohet në 361.5 ha si kullotë/livadhe, 438.9 ha si sipërfaqe jo prodhuese (inproduktive) përfshirë edhe sipërfaqet ujore (shtretër lumenjsh) dhe 254.1 ha ishin kategorizuar si toka bujqësore apo troje e vendbanime.

Në vitin 2016, në sajë të reformës së decentralizimit të funksioneve administrative drejt Njërive të Vetqeverisjes Vendore, fondi pyjor dhe kullor i cili administrohej nga Ministria përgjegjëse për pyjet (në atë kohë ish Ministria e Mjedisit), u transferua drejt pushtetit vendor dhe EP Papadhi Çipin konkretisht, drejt administrimit nga bashkia Himarë.

Por le te marrin në analizë se si kanë evoluar sipërfaqja pyjore në këtë periudhë rreth 40 vjeçare në EP Papadhi Çipin.

Viti i planit	1985	2026	Dif.	Arsyet
Sipërfaqe pyjore totale (ha)	5549.89	4292	-1258	Për shkak të zjarreve dhe dëmtimeve një sasi e konsiderueshme e sipërfaqes ka kaluar në sipërfaqe me bimësi pyjore dhe një pjesë e tjetër aktualisht konsiderohen si kullotë për shkak
a. Trungishte	2068.39	1339.6	- 729	Dëmtuar nga zjarret, kryesisht, por edhe prerjet ilegale gjatë viteve
b. Cungishte	120.25	1529	+ 1409	Ndryshim evolutiv progresiv, nga forma e qeverimit shkurre
c. Shkurre	3357.25	1423	- 1934	Kanë kaluar në një formë qeverisje me të avancuar, kryesisht cungishte
Sipërfaqe jo pyjore	1054.5	2566	1512	Zjarret dhe keqadministrimi
Sip.me bimësi pyjore (SBP)	0	849	+849	Shtuar si kategori e re nga ligji 57/2020. Mbulesa më e vogël se 10% nga bimësia pyjore
Kullota	361.5	1252.3	+890.8	
Sipërfaqe joproduktive	438.9	380.8	- 58.1	Një pjesë e këtyre sipërfaqeve kanë kaluar në kategorinë SBP
Toka bujqësore/troje	254.1	78.4	-157.7	Janë përjashtuar nga transferimi për shkak të pronësisë private.
TOTAL EP	6600.39	6858.0	+258	Shtesa për shkak të korrektimit digjital të sipërfaqeve (hartografim GIS)

Megjithëse më sipër jemi munduar të japim shpjegimet e shtesave dhe pakësimeve dhe kalimin e sipërfaqes nga një formë në një formë tjetër përdorimi, ajo që dëshirojmë të theksojmë është se EP Papadhi Çipin ka një shtesë në sipërfaqe të saj prej 258 ha, brenda të njëjtit kontur. Arsye e kësaj shtese është vetëm përmirësimi i metodës së matjes nëpërmjet hartografimit GIS.

Nëse i referohemi historikut të rezultateve ndërmjet dy planeve të mbarështimit në lidhje me funksionet e pyjeve, rezulton se sipas planit të mbarështimit të vitit 1985, sipërfaqja e përgjithshme pyjore prej 5545.89 ha ndahej në 3140.75 ha me pyje prodhues dhe 2405.14 ha pyje me funksion mbrojtës. Arsya thelbësore e krijimit të pyjeve mbrojtës duhet të ketë qenë logjikisht pjerrësia e territ mbi të cilat janë vendosur pyjet e kësaj EP.

Ndërsa sipas planit aktual të mbarështimit janë propozuar 1337 ha me funksion mbrojtës dhe 577 ha me funksion "Mbrojtës+Prodhues". Në pamje të parë duket sikur ka një rënie të sipërfaqes së mbrojtur, por në fakt po t'i referohemi pakësimit të sipërfaqes pyjore në tërësinë e saj, sipërfaqja e shpallur me funksion mbrojtës është rritur. Kjo pasi kalimi i sipërfaqes pyjore në kategoritë e tjera si psh "Sipërfaqe me Bimësi Pyjore" apo "Kullota", nuk e reflekton këtë funksion të dhënë.

Nëse konsiderojmë volumet respektive të gjetura në planin e mbarështimit të vitit 1985 me ato të gjetura në planin e mbarështimit të vitit 2026, rezulton kjo panoramë:

Në vitin 1985 kemi një volum të përgjithshëm të lëndës drusore në këmbë prej 223 000 m³, ndërsa në vitin 2026 volumi i përgjithshëm i llogaritur është 209 622 m³. Ashtu sikundër mund të shikohet ka një humbje në volumin e përgjithshëm prej 13 732 m³. Kjo humbje i dedikohet zjarreve në rëna në vite në këtë EP, kryesisht dhe djegia e halorëve si pishë e zeze dhe bredh.

Pas vitit 1990, vit i cili përkon me prishjen e sistemit shtetëror të centralizuar dhe kalimit në ekonominë e tregut, shfrytëzimi i pyjeve është kryer nga subjektet private të liçensuara për këtë qëllim. Pavarësisht se sasia e materialit drusor nuk ka qenë e shumë shfrytëzimet kanë vijuar, kryesisht për sigurimin e druve të zjarrit nga banorët vendas. Dëme të konsiderueshme kjo ekonomi pyjore ka patur gjatë vitit 1997, deri në vitin 1999, kohë e cila përkon me daljen jashtë funksionimit të shumë institucioneve.

Planifikimi 10-vjeçar, i planifikuar në planin e Mbarështimit të vitit 1985, nuk është realizuar ose është shkelur cdo parim i tij. Janë kryer disa investime të vogla, me fondet e ish projektit të pyjeve të cilat kanë patur impakt në përmirësimin e cungishteve, kryesisht në pjesët e ulëta të ekonomisë, e disa të tjera rreth zonave të banuara.

II.6 Situata demografike dhe socio-ekonomike

Ekonomia Pyjore "Papadhi Çipin" përbëhet nga komunitete lokale të cilat janë pjesë e Njësisë Administrative Horë Vranisht të Bashkisë Himarë. Fshatrat të cilat janë në brendësi të kësaj ekonomie janë: shatrat; Vranisht, Kuç, Kuç Buronjë, Bolenë, Kallarat, Tërbaç, të cilët përgjithësisht janë prekur nga lëvizjet demografike. Horë Vranishti ka qene qendra me e madhe e gjithë ekonomisë para viteve '90, si nga numri i popullsisë por edhe nga sipërfaqja e konsiderueshme e banimit.

Sipas të dhënave të marra nga Njësia Administrative respektive, trendi i numrit të popullsisë në këtë njësi ka patur një rënie të jashtëzakonshme, kjo në sajë të migrimit të popullsisë si drejt qendrave të mëdhaja urbane ashtu edhe lëvizjet migratore drejt shtetit fqinjë Greqisë.

Pavarësisht se tokat bujqësore janë të pakta, por pjelloria e tyre është e jashtëzakonshme, megjithatë veprimtaria në lidhje me bujqësinë ka rënie të ndjeshme. Shumë toka preferohen të kultivohen me bimë monokulturë në funksion të sigurimit të ushqimit blegtoral.

Edhe numri i blegtorisë ka shënuar rënie të ndjeshme, sidomos këto 4 vitet e fundit. EP Papadhi Çipin siguron kullota shumë të pasura përgjatë gjithë sezonit për shkak të vendodhjes dhe pozicionimit gjeografik të favorshëm. Kullotat verore frekuentohen deri në mesin e qershorit, pastaj në mungesë të reshjeve ato thahen dhe bëhen të papërshtatshme, kështu që blegtorët shtegtojnë drejt zonës juglindore në malin e Gramozit dhe në zonën e lartë midis Skraparit e Korçës.

Ashtu si numri i popullsisë që jeton në brendësi të EP dhe në periferi të saj, edhe blegtoria dhe fermat blegtorale që gjenden në brendësi dhe në periferi të EP, është një indikator sinjifikativ i gjendjes së fondit pyjor e kullosor të saj. Blegtoria e imët sidomos të dhirat kanë një ndikim të madh me efekt negativ mbi pyllin dhe ekspansionin e tij për shkak të dëmtimit të drurëve/shkurreve apo filizave nga kullotja. Por aq sa ndikim negativ kanë, ato luajnë një rol të rëndësishëm në fazat kur pylli është ngritur dhe ato ndihmojnë në krasitjen natyrore dhe seleksionimin nayror për një kohë më të shejtë sesa ndosh nën efektet graduale të natyrës. Por jo vetëm, pasi zënia në punë e popullatave me blegtoinë është gjithashtu një indikator i cili tregon se presioni ndaj pyllit është më i ulët duke sjellë më pak dëmtimin e tij.

Tokat bujqësore. Një kriter mjaft i rëndësishëm për të vlerësuar situatën social ekonomike të EP Papadhi Çipin, është edhe sasia dhe mënyra e përdorimit të tokës bujqësore nga banorët që jetojnë në zonat rurale të ekonomisë.

Sa më e madhe të jetë sasia e tokës bujqësore dhe sa më shumë të përdoret e kultivohet ajo, aq më pak presion do të ushtrohet mbi sipërfaqet pyjore që do të përkthehet në një zhvillim të qëndrueshëm dhe të vijueshëm të tij.

Nga të dhënat e marra nga Drejtoria e Statistikave, pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural rezulton së NJ. A. Horë Vranisht të ketë një sipërfaqe toke bujqësore prej 635 ha. Për shkak të fazave të regjistrimit fillestar, asnjë nga fshatrat e dy njësive nuk kanë të dhëna të sakta mbi tokën bujqësore, kështu që e dhëna do të përdoret si një e tërë për të gjithë njësinë administrative.

Nga studimet dhe vëzhgimet e kryera në zonën e studimit rezulton se ekosistemi i tokave bujqësore zë një pjesë të mirë të hapsirës dhe shtrihet në zonën e ulët dhe pranë zonave të banuara në EP Papadhi Çipin. Përfaqësohen kryesisht nga tokat e mbjella me kultura të ndryshme bujqësore dhe nga pemët drufrutore të cilat janë mjaft të përhapura në këtë hapsirë. Flora e tokave të kultivura është në përgjithësi e varfër dhe monofite, e përfaqësuar kryesisht nga të lashtat dhe kulturat prashitëse. Nga bimët më të përhapura përmëdim: gruri (*Triticum vulgare* Vill.), tërshera (*Avena sativa* L.), misri (*Zea mays* L.), qepa (*Allium cepa* L.), hudhra (*Allium sativum* L.), prasi (*Allium porrum* L.), spinaqi (*Spinacia oleracea* L.), pazia (*Beta vulgaris* varietet cicla L, lule lakra (*Brasica oleracea* var *botrys* L.), fasulja (*Phaseolus vulgaris* L.), jonxha (*Medicago sativa* L.), karota (*Daucus carota* L.), rozmarina (*Rosmarinus officinalis* L.), nenexhiku (*Mentha piperita* L.), domate (*Solanum lycopersicum* L.), patellxhani (*Solanum melongena* L.), patate (*Solanum tuberosum* L.), kungulli (*Cucurbita pepo* L.), susaku (*Lagenaria vulgaris* L.), shalqini (*Cucumis citrullus* Ser.), kastravec (*Cucumis sativus* L.), pjepri (*Cucumis melo* L.), lule dielli (*Helianthus annus* L.), etj.

Nga drufrutoret që mbillen në këtë hapsirë përmëdim: ulliri (*Olea europea* L. ssp *sativa*).arra (*Juglans regia* L.), fiku (*Ficus carica* L.), mani (*Morus alba* L.), kajsia (*Armeniaca vulgaris* L.), bajame (*Amygdalis communis* L.), pjeshka (*Persica vulgaris* Mill.), kumbulla (*Prunus domestica* L.), qersh (*Prunus avium* Moench.), ftoi (*Cydonia vulgaris* Pers.), dardha (*Pirus communis* L ssp, *sativa* Dc.), molla (*Malus domestica* Borkth.), limoni (*Citrus limonium* Risso.), mandarina (*Citrus nobilis* Lour), portokalli (*Citrus aurantium* L.), hardhia (*Vitis vinifera* L.), shega (*Punica granatum* L.), kakia (*Diospyrus kaki* L.).

Nga sa është vërejtur tokat bujqësore në të gjithë territorin e EP nuk janë në maksimumin e kultivimit të tyre, por vlen të theksohet se shumica e tyre janë nën kulturë. Vërehet fenomeni i zënies së tokës bujqësore për prodhimin e drithërave nga kulturat e ullirit dhe vreshtave në përgjithësi. Gjithashtu, pavëresisht se nuk a asnjë statistikë një sipërfaqe e konsiderueshme nga fondi pyjor, është përshtatur tashmë për kultivimin e ullirit dhe llojeve të ndryshme të vreshtave. Banorët pretendojnë për pronësinë mbi to, pavarësisht se askush nuk rezulton me dokumenta të pronësisë.

Në kohën kur sektorët e shfrytëzimit ishin në punë, kishin bërë të mundur që një numër i konsiderueshëm i popullsisë së këtyre fshatrave të punësoheshin në këto sektorë. Me mbylljen e ndërmarrjes së shfrytëzimit këta punëtorë ngelën të papunë, çfarë solli dhe një lëvizje të madhe të popullsisë drejt qyteteve, punësimit në sektorë të ndryshëm privatë si dhe një pjesë mirë ju drejtuan emigracionit.

Aktualisht të ardhurat kryesore të komunitetit janë siguruar deri me tani nga remitancat e emigrantëve, të cilët janë të punësuar sezonal në Greqi, por situata e vështirë në vendin fqinj, ka ulur ndjeshëm këta të ardhura dhe si pasojë një numër i konsiderueshëm i emigrantëve kanë zgjedhur të kthehen përsëri në vendin e tyre. Në përgjithësi ka tendenca për të zhvilluar sektorin bujqësor, në fshatrat e kësaj komune, ku përparësi duket se kanë ngritja e vreshtarisë me dru frutorë, të tillë si ullishtet, rrushi, molla, etj.

Sa i përket mundësive të punësimit në zonën e marrë në studim, banorët vendas kryesisht janë të punësuar në aktivitete dhe sipërmarrje private qoftë në sektorin bujqësor, apo blegtoral, por edhe atë të punësimit në karerat gurore të aktivizuara këto 10 vitet e fundit.

Një mundësi e mirë punësimi po konsiderohet edhe rikthimi i banorëve të larguar më herët nga këta zona, të cilët po kthehen për të investuar në fushën e turizmit. Vlen të përmendim këtu punën për ngritjen e dy bujtinave të cilat janë në proces dhe mjaft shtëpive e vilave të rindërtuara së fundmi, kryesisht në aksin rrugor që lidh bypassin e Vlorës me Palasën. Puna në sektorin e pyjeve është, shumë e vogël ose thuajse e papërfillshme. Pyjet nuk arrijnë të prodhojnë vende pune të mjaftueshme për banorët vendas, por ato konsiderohen një burim i qëndrueshëm furnizimi për sigurimin e të mirave, si dru zjarri, apo prodhime të dyta pyjore.

II.7 Tregtimi i prodhimeve pyjore drusore dhe jodrusore

Tregtimi i prodhimeve drusore dhe jodrusore për zonën në të cilat shtrihen pyjet dhe kullotat e EP Papadhi Çipin, janë pothuajse inekzistente. Emigrimi i të rinjve dhe fuqisë aktive për punë, ka bërë që ekspansioni i pyllit të jetë i shpejtë duke ulur ndjeshëm sipërfaqet kullosore dhe në disa raste edhe tokat bujqësore.

Prodhimet drusore kryesisht përfaqësohen nga drutë e zjarrit dhe më rrallë nga prodhimet e tjera që lidhen me punimet pyjore (nga krasitjet apo rrallimet) të kryera nga fshatarët për nevojat e tyre. Përveç druve të zjarrit, çka përbën deri 85% të nevojave lokale, nga fshatarët mund të përdoren prodhime të tjera drusore, si material ndërtimi për ruajtjen e bazës ushqimore për bagëtitë dhe hunj gardhesh në tokat bujqësore. **Rezulton që tregtimi i prodhimeve drusore është i rrallë tek banorët.** Vlerësohet që tregtimi lidhur me shfrytëzimin e lëndës drusore për qëllim industriale mungon.

Prodhimet jodrusore gjithashtu përdoren më së shumti për nevojat lokale, me nivel të ulët tregtimi. Në zone ka mjaft specie pyjore dhe bime mjeksore që mund të grumbullohen dhe

tregtohen pasi ka kërkesa në treg për to, por për shkak të mungesës së fuqisë punëtore ato nuk vilen dhe nuk përdoren si burim të ardhurash nga banorët.

Gjithsesi një informacion mbi sasinë e BMET është grumbulluar si duke mbajtur parasysh gjendjen dhe sasinë e tyre në ekonomi, ashtu dhe nga të dhënat e marra nga banorët e zonës.

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia në 10 vjet	Çmimi për njësi (lekë)	Vlera gjithsej (lekë)
1	Dëllinjë e Kuqe	ton	15	150'000	2'250 000
2	Sherebelë	ton	13	200'000	2'600'000
2	Trumëz	ton	8.7	180'000	1'566'000
	Gjithsej				6' 416'000

Me një mesatare të çmimeve aktuale në treg, është llogaritur se nga grumbullimi i dhe trajtimi i BMET në EP Papadhi Çipin të mund të sigurohet një e ardhur prej rreth 6.5 milion lekësh.

II.8 Gjuetia dhe peshkimi

Megjithë gjuetinë ilegale e cila ekziston në zonë, ka një shtim të ndjeshëm të kafshëve të egra dhe veçanërisht të thëllenzës, derrit të egër dhe lepurit dhe kjo thuhet në të gjithë territorin e veshur me pyje të ekonomisë.

Habitatet natyrore që gjenden në brendësi të territorit të EP Papadhi Çipin, karakterizohen nga një diversitet i lartë dhe gjendje e ruajtur. Sipërfaqja e madhe e zonave të mbrojtura kurora e gjelbër e Himarës, mjediset ujore të përfaqësuar nga lumenj dhe rezervuarë, krijojnë kushte të përshtatshme për jetesën e një numri të lartë gjallesash të cilat shtegtojnë dhe lëvizin nga njëri habitat në tjetrin. Nga inventarizimet e kryera të grupeve të synuara të faunës (gjitarë, shpendë, zvarranikë, amfibë) rezultojnë se gjenden shumë lloje të rëndësishme në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Një numër i madh i vertebrorëve që gjenden në zonë gëzojnë mbrojtje strikte (SPS- specie në mbrojtje strikte) ose janë të mbrojtura (9S- specie të mbrojtura) nga ligji shqiptar (ligji për Mbrojtjen e Faunës dhe aktet rregullatore përkatës).

Sipas studimeve paraprake, (burimi: https://ëëë.BioSouth.al/uploads/2019/1/TR030_VSM-report.pdf) rezultojnë të dhënat si në tabelën më poshtë:

Taksoni	Nr. i llojeve që gjenden në zonën e studimit	Nr. i llojeve në listën kombëtare	Përqindja (%) në raport me nr. total
Gjitarë	53	71	74.6
Shpendë	130	330	39.3
Zvarranikë	28	37	75.6
Amfibë	13	15	86

Amfibët. Habitatet e ndryshme favorizojnë jetesën e një numri të lartë amfibësh. Vrojtimet e kryera kanë evidentuar praninë e 13 llojeve (që përfaqësojnë 86 % të llojeve në nivel kombëtar), dhe kjo lidhet me praninë e lartë të habitateve ujore (lumenj, përrenj, rezervuar, liqene artificiale, etj.) të cilët përbëjnë zona të rëndësishme për riprodhimin dhe ruajtjen e popullatave të amfibëve. Disa lloje amfibësh (*Triturus cristatus*, *Triturus vulgaris*, *Bombina variegata*, *Rana balcanica*, *Rana lessonae*) janë të lidhura më ngushtësisht me mjedisin ujor dhe më pak me atë tokësor. Ndërsa disa lloje amfibësh (*Salamandra salamandra*, *Bufo bufo*, *Bufo viridis*, *Hyla arborea* e *Rana dalmatina*) zbresin në mjedisin ujor për t'u riprodhuar dhe për të lëshuar vezët dhe, pas kësaj largohen duke kaluar në mjediset tokësore. Amfibët kanë shpërndarje vertikale që shtrihet nga mjediset ujore, shkurretat mesdhetare, pyjet e dushkut. Nga llojet e amfibëve të pranishëm në zonë vetëm dy prej tyre (*Rana balcanica*, *Rana lessonae*) kanë status të përkeqësuar (VU), kryesisht për shkak të mbipeshkimit për qëllime tregtimi.



Thithlopa (*Bufo bufo*)



Bretkosa e përrenjeve (*Rana graeca*)



E bukura e dheut (*Salamandra salamandra*)



Bretkosa e leshterikut (*Rana lessonae*)



Bretkosa barkverdhw (*Bombina variegata*)



Tritoni me kreshtë (*Triturus cristatus*)

Zvarranikët. Vrojtimet e kryera në habitatet natyrore në zonën e Himarës kanë evidentuar praninë e 28 lloje zvarranikësh (që përfaqësojnë 75.6 % të llojeve në nivel kombëtar), nga të cilët tre lloje janë me status të rrezikuar në mënyrë kritike (CR) (*Typhlopsvermicularis*, *Elaphe quatorlineata*, *Coluber gemonensis*), një lloj i rrezikuar (EN) (*Elaphe longissima*) dhe një lloj me status të përkeqësuar (VU) (*Mauremys caspica*). Reptilët janë të lidhur me një diversitet habitatesh ku përfshihen mjedise buqësore, rezervuarë, lumenj, shkurreta mesdhetare, zona e ahut dhe kullotat alpine. Terrenet e lëndinave dhe ato buqësore përfaqësojnë mjedise më të thjeshta, pak a shumë homogjene dhe ofrojnë pak niche ekologjike. Këto mjedise karakterizohen nga numër i vogël llojesh ku më të pranishëm janë *Lacerta trilineata*, *Podarcis taurica*, *Pseudopusapodus*, *Coluber najadum*, *Elaphe longissima*, *Malpolon monspessulanus*. Megjithëse lloje me gjak të ftohtë, katër lloje zvarranikësh (*Emys orbicularis*, *Mauremys caspica*, *Natrix natrix* e *Natrix tessellata*) janë të lidhur me mjediset ujore, të cilat shërbejnë si zona ushqimi, ndërsa inkubimi i vezëve bëhet në tokë. Shkurretat mesdhetare janë një habitat ideal për zvarraniket, ku dhe gjendet numri më i lartë i tyre (21 lloje) me llojet përfaqësues si *Testudo hermanni*,

Cyrtodactylus kotschy, Lacerta viridis, Podarcis muralis, Coluber jugularis, Coluber gemonensis, Elaphe longissima, Malpolon monspessulanus, Natrix natrix, Typhlops vermicularis, Vipera ammodytes). Familja Viperidae është e përfaqësuar nga tre lloje ku, nepërka me brire (Vipera ammodytes) ka përhapjen vertikale më të gjerë nga 100 m – 1000 m, ndërsa dy llojet e nepërkave (Vipera ursinii dhe Vipera berus) gjenden mbi dhe në lartësinë 1000 m mbi nivelin e detit.



Gjarpri i ujit (*Natrix natrix*)



Breshkujza e ujit (*Emys orbicularis*)



Breshka e zakonshme (*Testudo hermanni*)



Hardhuca e mureve (*Podarcis muralis*)



Hardhucë bari (*Podarcis taurica*)



Zhapiu i gjelbër (*Lacerta viridis*)

Shpendët: Të dhënat e marra nga studimet tregojnë se në zonën e studimit gjenden 130 lloje shpendësh (që përfaqësojnë 86 % të llojeve në nivel kombëtar), nga të cilat 34 lloje janë të përfshira në listën e kuqe të vendit. Kjo shifër është e lartë dhe shpjegohet jo vetëm me sipërfaqen e madhe por edhe me diversitetin e lartë të habitateve, përbërjen heterogjene dhe prodhimtarinë e lartë të pyjeve dhe shkurretave. Këto mjedise sigurojnë kushte për shumimin e një numri të madh lloje shpendësh. Nga numri i përgjithshëm, 76 lloje janë rezidentë, 20 lloje janë dimërues, 37 lloje janë vizitore gjatë verës dhe 7 specie janë shtegtare. Pyjet e ahut në zonën e Malit të Gamtit, strehojnë komunitetet e shpendëve në stinën e pranverës, verë, dhe në fillim të vjeshtës. Në stinën e verës këto pyje shërbejnë për shumimin e llojeve si Falco subbuteo, Columba palumbus, Bubo bubo, Strix aluco etj. Në katin e dushqve grupi dominues është rendi i haraballorëve. Ndër përfaqësuesit me tipikë të këtij grupi do të dallonim pjestarët e familjes Corvidae me Garrulus glandarius, Pica pica, Aegithalos caudatus, Parus major, Picus viridis. Shkurretat mesdhetare janë vendi i parapëlqyer për një numër të madh llojesh, të gjithë pjestarët të Rendi Haraballorë ku dominojnë Familjet Silvidae, Paridae, Turdidae, Fringillidae etj. Ndër llojet me karakteristike dallojmë: Sylvia atricapilla, S. melanocephala, S. cantillans, Turdus merula, Parus caeruleus, Carduelis carduelis, Alectoris graeca, Scolopax rusticola etj. Mjediset e tokave bujqësore dhe lëndinat grumbullojnë një numër të lartë shpendësh, sidomos gjatë sezonit të dimrit, në kërkim të ushqimit. Nga shpendët e ujit më e zakonshmja është Pulëbardha e zakonshme (Larus ridibundus), por shumica e tyre janë individë të Familjes Fringillidae, ndër to do të përmendnim Carduelis carduelis, Fringilla coelebs, Carduelis chloris, Serinus serinus etj. Gjatë periudhës së shtegtimit, tokat bujqësore vizitohen dhe nga një numër rrëmbenjësish shtegtare ku spikat lloji globalisht i kërcënuar i skifterit kthetraverdhë (Falco naumanni). Shpendët e ujit përfaqësojnë vetëm një numër të vogël të llojeve. Lumenjtë, rezervuarët dhe liqenet artificiale

përdoren kryesisht gjatë dimrit dhe shumë pak gjatëverës. Ato strehojnë lloje si rosa (*Anas platyrhynchos*), kredharakë (*Tachybaptus ruficollis*), gakthi i vogël (*Ixobrychus minutus*), pula e ujit (*Gallinula chloropus*), të cilët janë folezues në këto mjedise.



Gala (*Corvus monedula*)



Pula e ujit (*Gallinula chloropus*)



Zhtësi i vogël (*TACHYBAPTUS RUFICOLLIS*)



Qafdrdhësi (*Jynx torquilla*)



Gardalina (*Carduelis carduelis*)



Kumria (*Streptopelia decaocto*) dhe Kukuvaika

Gjitarët: Gjitarët kanë numrin më të përfaqësuar të vertebrorëve, dhe studimet e kryera tregojnë për praninë e 53 llojeve. Habitatet natyrore të pyjeve të larta dhe brezit të shkurretave janë strehë për disa lloj gjitarësh karnivorë, ndërsa mjediset e shpellave shërbejnë si vend strehimi dhe shumimi për 21 lloje lakuriqësh nate (32 lloje në nivel kombëtar). Pyjet me halorë dhe dushqet ofrojnë habitat të përshtatshëm për ushqimin dhe shumimin e një numri të gjerë gjitarësh siç janë ariu (*Ursus actos*), ujku (*Canis lupus*), derri i egër (*Sus scrofa*), kunadhja (*Martes foina*), kaprolli (*Capreolus capreolus*), ketri (*Sciurus vulgaris*), gjumash (*Glis glis*), gjumashi i pyllit (*Dryomys nitedula*). Në katin e shkurretave mesdhetare fauna e gjitarve është e pasur si nga pikëpamja cilësore (llojshmëri) dhe sasiore (numër individësh brenda llojit). Ndër llojet obligatore të shkurretave mesdhetare përmendim dhelprën (*Vulpes vulpes*), baldosën (*Meles meles*), qelbësin (*Mustela putorius*), gjerin (*Glis glis*), gjumashin e lajthisë (*Muscardinus avellanarius*), miun gushëverdhë (*Apodemus flavicollis*). Lloje të tillë si nuselalja (*Mustela nivalis*), minjtë (*Apodemus sylvaticus*, *A. mystacinus*, *Microtus epiroticus*, *M. felteni*, *M. thomasi*, *Mus musculus*), lepuri i egër (*Lepus europeus*), lakuriqët e natës të gjinive *Rhinolophus*, *Pipistrellus* dhe *Myotis*, hundëgjatët (*Crocidura suaveolens* dhe *Suncus etruscus*) si dhe iriqi (*Erinaceus concolor*) konsiderohen si lloje shoqërues. Mjediset ujore dominohet nga lakuriqët e natës të cilët vizitojnë këto mjedise për ushqim (duke gjuajtur insekte nate) dhe pirje uji. Me interes të veçantë për këto mjedise është prania e lundërzës (*Lutra lutra*), e cila takohet në pjesën e sipërme të lumenjve të pasur me peshk, ku ndotja është e ulët. Nga gjitarët e vegjël përmendim dhelprën (*Vulpes vulpes*), baldosën (*Meles meles*) dhe nuselalen (*Mustela nivalis*). Numri i gjitarëve në tokat buqësore është relativisht i varfër në lloje dhe dominohet nga brejtësit dhe lakuriqët e natës që fluturojnë mbi këto mjedise në kërkim të ushqimit (insekteve të natës). Krahas këtyre grupeve këto mjedise frekuentohen dhe nga gjitare të tjere si lepuri i murme (*Lepus europeus*), dhelpra (*Vulpes vulpes*), nuselalja (*Mustela*

nivalis) dhe baldosa (Meles meles). Midis llojeve të brejtësve dhe lakuriqëve të natës më të zakonshëm përmendim Microtus epiroticus, M. thomasi, Mus musculus, Apodemus sylvaticus, Pipistrellus pipistrellus dhe P. kuhli. Karakteristike për mjediset e zonave të banuara është prania e brejtësve Mus musculus (M.m.domesticus), Rattus norvegicus, R. rattus, Apodemus sylvaticus, e hundegjatit të kopshteve (Crociodura suaveolens) dhe e urithit të verbër (Talpa stankovici). Shtëpitë e banimit ofrojnë strehë verore dhe dimërore për lakuriqët e natës të gjinisë Pipistrellus dhe Myotis. Këto habitate gjatë natës mund të vizitohen dhe nga gjitarë të tjerë mishngrënës si dhelpra (Vulpes vulpes), qelbësi (Mustela putorius) dhe nuselalja (Mustela nivalis).



Dhelpra (*Vulpes vulpes*)



Qelbësi (*Mustela putorius*)




Gjurmë të lundrës (*Lutra lutra*)



Urithi i verbër (*Talpa stankovici*)



Hundgjati dhembkuq (*Neomys anomalus*)



Lakuriqnate hundepatkua (*Rhinolophus sp.*)

Në të gjithë sipërfaqen pyjore (por jo vetëm) prej 4292 ha, ka një mbipopullim me kafshë të egra sidomos me thëllëzat dhe lepurin e egër. Ariu gjendet gjithashtu në këtë zonë, ndërsa ujku çuditërisht nuk ka shenja të ekzistencës së tij.

Tashmë me rënien dhe përfundimin e moratoriumit aktual të gjuetisë së faunës së egër, gjuetia është një aktivitet i cili mund të sigurojë të ardhura të konsiderueshme për bashkinë.

II.9 Infrastruktura rekreative dhe didaktike

Infrastruktura rekreative që prek skajin e jashtëm të ekonomisë pyjore Papadhi Çipin, lidhet kryesisht me aktivitete të tilla në të gjithë zonën, por njëkohësisht edhe zhvillimet e fundit që kanë për tendencë ngritjen e agroturizmave. Karstet gëlqerore të zonës por në veçanti ato të NJ.A të Horë Vranishtit përbën një atraksion turistik dhe me një lëvizje mjetesh e njërëzish dendur përgjatë gjithë vitit. Për këtë qëllim ka filluar edhe ngritja e infrastrukturës aktuale në funksion të zhvillimit të turizmit apo atraksioneve turistike në të gjithë zonën e studimit, megjithatë ekzistojnë kushte dhe premisa për ta zhvilluar këtë sektor në të ardhmen. Cilësia e peizazheve të ndryshme ofron mundësinë për të zhvilluar infrasktrukturën dhe objektet turistike, bazuar në ato

ekzistuese të pakta (shtigje, zona pikniku) dhe me qëllim zhvillimin e ekoturizmit dhe ngritjen e përshatjen e shtëpive të banimit për turizëm rura. Zona e Horë Vranishtit karakterizohet nga një kulinari tepër e pasur dhe mjaft cilësore, gërshetuar kjo me prodhimet totalisht BIO të zonës.

II.10 Prania e siteve dhe specieve me vlera të larta mbrojtjeje

Zona e studimit në fakt, paraqet një ekosistem me vlera të shtuara si në aspektin e biodiversitetit ashtu edhe të sistemeve pyjore. Prania e pishës së zezë dhe e bredhit të maqedonisë, përbën një zonë me interes të veçantë për t'u studiuar, megjithatë dëmtimet nga zjarri e vitëve të fundit po e rrezikojnë këtë areal natyror.

III. Situata aktuale e pyjeve dhe kullotave

III.1 Mbarështimi dhe funksionet e pyjeve dhe kullotave

III.1.1 Përdorimi i territorit (aktual dhe propozimet)

Tipet e përdorimit të territorit janë të pasqyruara mjaft qartë në tabelën nr 3.1. Sipërfaqja totale është 6858 ha dhe propozohet po ajo sipërfaqe prej 6858 ha. Nga kjo pyjore është 4292 ha dhe propozohet po ajo sipërfaqe prej 4292 ha.

Kullotat dhe livadhet në EP Papadhi Çipin zëjnë 1252 ha. Ato janë të vendosura në pjesën më të lartë të EP.

Toka bujqësore janë 70.8 ha, dhe po 70.8 ha propozohen me një përdorim të tillë.

Zona urbane në të gjithë konturin e EP është 7,6 ha, dhe po atë mbetet edhe në objektivat e këtij plani mbarështimi.

Sipërfaqja joproductive klasifikohet në një sipërfaqe prej 380.8 ha, dhe kryesisht janë shkëmbinjtë gëlqerore dhe karstet gëlqerorë në të gjithë kreshtat e EP.

Sipërfaqja me prezencë të ulët të bimësisë pyjore ose sic njihet edhe ligjerisht si Sipërfaqe me Bimësi Pyjore është konsideruar mjaft e madhe në këtë ekonomi pyjore. Ajo zë një sipërfaqe prej 849 ha në total. Origjina e saj është nga dy drejtime kryesore. Nga njëra anë ish zonat joproductive të mbetura në qetesi dhe pa presion të kullotjes, kanë filluar të gjenerojnë bimësi shkurre kryesisht të prallit apo shkurretave mesdhetare. Kurse në krahun tjetër, i cili konsiderohet edhe si efekti negativ i krijimit të këtij grupimi, janë degradimi i zonave pyjore për shkak të zjarreve, ku rikthimi i bimësisë ka filluar por ai mbetet akoma nën një mbulesë më të vogël së 8-9% të sipërfaqes së përgjithshme të n/parcelës.

<u>Perd.teritorit</u>	<u>Aktuale</u> <u>Siperfaqja ha</u>	<u>E propozuar</u> <u>Siperfaqja ha</u>
Total		
Pyll	4292.0	4292.0
Sip.me bim. pyjore	849.1	849.1
Bujqesi	70.8	70.8
Kullote, Livadh	1252.3	1252.3
Urbane	7.6	7.6
Ujore	0.0	0.0
Kenete, Mocal	0.0	0.0
Djerr	5.4	5.4
Joproductive	380.8	380.8
Total:	6858.0	6858.0

perd terit aktual

perd terit propozuar

Tabela III.1 Tabela me të dhëna mbi përdorimin e territorit në EP Papadhi Çipin.

Siërfaqja djerr prej 5.4 ha, ndodhet në afërsi të fshatit Bolenë dhe janë ish toka bujqësore të lëna djerr, por me origjinë nga ish fondi pyjor i kësaj ekonomie. Sipërfaqja djerr nuk është propozuar për të ndryshuar formën e përdorimit të saj, për shkak të shkëmbit amnor gëlqeror që del në sipërfaqe dhe nuk garanton zhvillim të qëndrueshëm të bimësisë.

III.1.2 Regjimi i qeverisjes (aktuale dhe propozimet)

Forma e qeverisjes së ekonomisë merr për bazë Mbarështimin e mëparshëm dhe në të shumtën e rasteve e ruan atë me përjashtime të rralla kur sipërfaqja ka ndërruar funksion.

Më poshtë po japim të detajuar me tabelë, gjendjen aktuale dhe të propozuar të formës së qeverisjes në ekonommine pyjore "Papadhi Çipin".

FORMA E QEVERISJES

<u>Forma e qeverisjes</u>	<u>Aktuale</u>		<u>E propozuar</u>	
	<u>Sipërfaqja ha</u>	<u>%</u>	<u>Sipërfaqja ha</u>	<u>%</u>

Ekonomia : EP Papadhi-Cipin

Trungishte	1310.2	30.5	1310.2	30.5
Cungishte	1257.6	29.3	1570.8	36.6
Trung. e parregullt	29.4	0.7	29.4	0.7
Cung. e perbere	271.4	6.3	39.2	0.9
Shkurre	1423.4	33.2	1342.4	31.3
Livadh	0.0	0.0	0.0	0.0
Kullote	0.0	0.0	0.0	0.0
Kullote me drure	0.0	0.0	0.0	0.0
Kullote me shkurre	0.0	0.0	0.0	0.0
Total:	4292.0		4292.0	

Ne Total:




Tabela nr.III.1.2 Forma e qeverisjes sipas Mbarështimit aktual dhe atij të propozuar.

Sic shihet edhe nga pasqyra, nuk ka ndryshime thelbësore të formës së qeverisjes nga mbarështimi më përparshëm. Kështu forma e qeverisjes trungishte mbetet po e njëjtë nga ajo që është gjetur gjatë inventarizimit të grumbullit në 1310 ha ose në 30.5% të totalit të sipërfaqes pyjore.

Cungishtja e thjeshtë shtohet me rreth 313 ha dhe kjo shtesë vjen si rezultat i pakësimit të cungishtes së përbërë, pasi janë planifikuar që të hiqen drurët e vjetër me formë qeverimi trungishte, duke e kovertuar automatikisht në cungoshte të thjeshtë. Nga kjo lëvizje përfitohen 232 ha, ndërsa pjesa tjetër e shtesës vjen si rezultat i tendencës së ndërhyrjeve të propozuara në formën e qeverimit shkurre, ku u jepet prioritet zhvillimit të dushqeve.

Shkurret po ashtu pakësohen në sipërfaqen e tyre të përgjithshme dhe ky pakësim shkon në favor të formës së qeverimit cungishte e propozuar.

III.1.3 Ndarja e Ekonomisë Pyjore në parcela dhe n/parcela

Ekonomia pyjore Papadhi Çipin, është njësi homogjene territoriale. Si e tillë, bazuar në konfiguracionin e terrenit, në homogjenitetin e grumbujve si dhe karakteristikat dendrometrike e morfologjike të grumbujve pyjorë, ajo për bëhet 163 parcela dhe 568 njësi administrative (nën-parcela) organizimi brenda saj.

Ndarja e ekonomisë në ngastra dhe n/ngastra bëhet me qëllim sigurimin e orientimit, organizimit, udhëheqjen dhe kontrollin e kryerjes së punimeve pyjore (pyllëzime, përmirësime, shfrytëzime, ripërtëritjen e pyllit, etj) si dhe trajtimi i përshtatshëm që duhet zbatuar në pyll. Në ndarjen për ngastër mbahen parasysh format natyrore të rilievit (si përrenjë, lugina, kulme etj).

Janë ruajtr tërësisht kufijtë e vjetër të ndarjes së ngastrave duke plotësuar dhe një kusht të manualit të punimeve të terrenit. Ndërsa numri i nënngastrave thuajse është trefishuar nga plani i mbarështimit të vitit 1985. Kjo ka ardhur si pasojë e ndryshimeve strukture dhe morfologjike që ka pësuar grumbulli përgjatë këtyre 40 viteve. N/ngastra duke qënë njësi bazë për studimin e pyllit dhe planifikimin e punimeve ka për bazë homogjenitetin e pyllit. Sipërfaqja minimale është 0.5 ha, por për të shmangur mosfunksionimet e programeve kompjuterike dhe mbivendosjet në harta ka dhe njësi me sipërfaqe më të vogël.

Në mjaft raste ka patur ndarje të reja në varësi të gjëndjes aktuale të pyllit. Madhësitë e ngastrave dhe n/ngastrave plotesojnë tërësisht kërkesat e Manualit të Mbarështimit, për këtë qëllim në pyjet prodhues ashtu dhe mbrojtës emërtimi i çdo n/ngastre është i ndryshëm brenda një ngastre.

Për të ruajtur tërësinë konturiale të EP Papadhi Çipin, pjesët dhe sipërfaqet e pa-emërtuara, janë poligonizuar me numrat rendor 164, 165, 166 dhe 167. Theksojme se sipërfaqja e tyre e përgjithshme prej 1827 ha, veçse plotëson konturin e EP por nuk është pjesë e kompozimit të këtij PM.

IV. Përshkrimi i stacionit

IV.1 Klima

Ekonomia Pyjore "Papadhi Çipin" bën pjesë në zonën e klimës mesdhetare paramalore. Studimi i klimës në këtë ekonomi është bërë duke u bazuar në të dhënat metereologjike të regjistruara në vite nga stacioni me afer ekonomise. Klima e kësaj ekonomie varet nga barriera malore e Malit të Cipinit dhe e Malit të Pilurit, që pengojnën disi erërat lindore dhe ato jugore të depërtojnë në brendësi të ekonomisë. Si pasojë ekonomia karakterizohet nga kemi verë të nxehta kryesisht për shkak edhe të kundrejtimit dominues perëndimor dhe dimra jo shumë të ashpër.

Një nga elementet bazë që karakterizon klimën e një zone është **regjimi i diellzimit**, i shprehur me anë të numrit të ditëve të kthjellëta e të vranëta. Për zonën në studim, numri i ditëve të kthjellëta luhet nga 6-7 ditë në muajt e dimrit deri në 16-19 ditë në muajt e verës. Mesatarisht gjatë vitit vërohet rreth 1-2 ditë të vranëta në periudhën e verës dhe 10-12 ditë të tilla gjatë e dimrit. Në tabelën e mëposhtme tregohet kohëzgjatja mesatare e ditës sipas muajve si dhe mesatarja e ditëve me temperature mbi 32°C dhe nën 0°C.

	Vjetore	JAN	SHK	MAR	PRI	MAJ	QER	KOR	GUS	SHT	TET	NEN	DHJ	Periudha studimore (vite)
Kohëzgjatja mesatare e ditës (orë)	12.7	10.1	11.1	12.4	13.8	15.1	15.7	15.3	14.3	12.9	11.5	10.4	9.8	3
Nr. i ditëve me temp. > 32°C	31	-	-	-	-	-	3	11	15	1	-	-	-	3
Nr. i ditëve me temp. < 0°C	34	10	6	7	-	-	-	-	-	-	-	-	10	3

Burimi: www.weatherbase.com

Për rajonin e EP Papadhi Çipin, (zona e Himarës në përgjithësi) rezulton se vlerat mujore të rrezatimit të përgjithshëm luhet nga 135,6 kal/cm² në muajin dhjetor deri në 570 kal/cm² në muajin korrik. Shifrat tregojnë një potencial të konsiderueshëm të energjisë diellore për zonën në studim, element ky shumë i favorshëm për zhvillimin e bimësisë së zonës.

Periudha e vegjetacionit fillon në fund të javës së parë të Prillit dhe mbaron në fund të javës së parë të Nëntorit për lartësinë deri në 900 m. Ndërsa për lartësinë deri në 1400 m, fillimi i vegjetacionit konstatohet në javën e parë të Majit, dhe mbaron në fillim të Tetorit.

Temperatura është një nga faktorët kryesorë që ndikon dhe ushtron influencën e sajë në zhvillimin normal ose jo të pyllit.

Temperatura percaktohet si mase e nxehtesise se ndjeshshme, dhe dhe eshte shume e rendesishme sepse ndikon ne madhesine intesitetin e avullimit, transpirimit, ne borteshkrijen si

dhe mbi formen e reshjeve. Vrojtimi i temperatures behet me ane te termometrave normal, maksimal dhe minimal. Temperatura minimale gjate dites ndodh zakonisht para lindjes se diellit ndersa ajo maksimale $\frac{1}{2}$ deri ne 3 ore pasi dielli te kete arritur lartesine maksimale. Termat qe lidhen me temperature dhe qe perdoren shpesh ne meterologji jane: temperature mesatare ditore, temperature mesatare mujore si dhe temperature mesatare vjetore. Temperatura peson ndryshime ne hapsire edhe me lartesine, megjithate kushtet mesatare duhet te percaktohen ne nje kohe dhe ne nje vend te caktuar.

Siç e përmendëm dhe më sipër, pozicioni gjeografik dhe format e ndryshme te relievit reflektohen ndjeshëm në kushtet klimatike të zonës, dhe sidomos në vlerat e temperaturave të ajrit.

Nje perfytyrim te pergjithshem te regjimit termik te nje zone jep shqyrtimi i vlerave mesatare vjetore të temperaturës.

Konkretisht, duke iu referuar stacioneve meterologjike perkatese temperatura mesatare vjetore per zonën në të cilën bën pjesë EP Papadhi Çipin eshte 15.1°C temperatura minimale eshte -10.4°C dhe makimale 41.5°C.

Keto jane vlera mesatare te nxjerra nga nje seri e gjate vrojtimesh (30, 40vjet) te pranuar nga Organizata Boterore e Meteorologjise referuar literatures ([Remenieras.R, Hidrology de l'Engineur, Eurolles, Paris](#))

Të dhëna mbi temperaturën mesatare mujore


Muajt	Jan	Shku	Mars	Prill	Maj	Qersh	Korr	Gush	Shtat	Teto	Nen	Dhjet
T. (në °C)	6.7	7.9	9.9	13.3	17.7	21.6	23.8	23.8	20.6	16.1	11.8	8.2

Siç shihet temperatura mesatare ka nje ecuri normale me nje maksimum ne muajt e veres dhe minimum ne muajt e dimrit. Keshtu muaji më i ftohte i vitit eshte Janari ku temperatura mesatare eshte 6.7°C ndërsa muaji me i ngrohte eshte muaji korrik dhe gusht me vlere te temperatures mesatare 23.8°C.

Grafikisht mesataret mujore të temperaturave të ajrit paraqiten si më poshtë:

Temperatura mesatare vjetore në ekonomi është 6-11°, temperatura absolute minimale është (-17,8°C), dhe maksimumi i saj (35,5°C).

Megjithatë këto vlera në vite të ndryshme dhe mjaft të rralla pësojnë dhe ndryshime ku temperatura minimale në vite ulet deri në (-28°C), dhe mund të ngrihet deri në (40°C)



Në muajt Mars dhe Nëntor regjistrohen temperaturat mesatare, ndërsa ato minimale në Dhjetor, Janar, Shkurt. Muajt Korrik dhe Gusht regjistrojnë dhe temperaturat maksimale.

Rreshjet

Në zonën e studimit sasia e reshjeve vjetore është rreth 1250mm. Në krahasim me vlerën mesatare të territorit shqiptar (1400mm), kjo zonë është më e ulët në sasinë e reshjeve atmosferike. Shpërndarja e reshjeve gjatë vitit ka një formë "U" që është tipike e një regjimi mesdhetar të reshjeve. Sasia më e madhe e reshjeve vërehet gjatë periudhës së ftohtë të vitit dhe muajt më të lagësht janë Nëntor-Dhjetor (162 dhe 141mm përkatësisht). Muaji më i thatë është Korriku (38mm).

	Vjetore	JAN	SHK	MAR	PRI	MAJ	QER	KOR	GUS	SHT	TET	NEN	DHJ	Periudha studimore (vite)
Sasia mesatare (mm)	1250	120	140	100	140	140	70	30	10	40	120	150	130	3
Nr. mesatar i ditëve me shi	78	8	7	7	8	9	3	3	1	3	7	9	9	3

Burimi: www.weatherbase.com

Rreshjet në formë dëbore sa vijnë e bëhen më të rralla dhe ato vërehen vetëm në majat e maleve respektivë. Rrallëherë ajo shfaqet edhe në kodrat që mbi Bolenë apo në malin sipër Bratit, por që zgjat vetëm disa orë. Reshjet e borës fillojnë zakonisht në Dhjetor dhe vazhdojnë deri nga mesi i Shkurtit rrallë herë edhe në Prill, por vetëm në majat e maleve të sipërcituar.

Rreshjet në formë breshëri bien zakonisht në periudhën e verës duke shkaktuar dëme jo të pakta si në grumbujt pyjor ashtu edhe në kulturat bujqësore të zonës.

Karakteristike për këtë pjesë të ekonomisë janë edhe **shkarkesat elektrike**, veçanërisht në periudhën e verës, të cilat në më të shumtën e rasteve kanë shkaktuar zjarre të cilat sjellin dëme të konsiderueshme në grumbujt pyjorë.

Megjithatë, vitet e fundit është vënë re një shmangie e këtyre mesatareve vjetore për shkak të ndryshimeve klimaterike. Kështu në këtë kontekst, formacionet e bredhit te maqedonise (..Borissi regia) janë drejt zhdukjes për shkak të rritjes së temperaturave dhe mungesës së lagështisë së ajrit. Kjo është vënë re gjatë inventarizimit të grumullit në parcelën

me prani të këtij lloji, të cilat në inventarin e vitit 1985 kanë patur në formacionin e grumbullit rreth 70% me bredh, ndërkohë gjatë këtij inventarizimi në të gjithë parcelën numërohen jo më shumë se 15 individë (drurë), dhe këto me shenja të sëmundjeve dhe tharjes së majave.

Rrjeti hidrografik është i varfër me përrrenj sezonalë kryesisht dimërorë që nuk kanë fuqi errodivë të madhe gjatë fryrjeve dimërore, për shkak të formacioneve gëlqerore, në të cilët ato janë vendosur.

Erërat

Në përgjithësi erërat fryjnë nga drejtime të ndryshme në këtë ekonomi, por mbizotërojnë erërat që fryjnë nga drejtimet Jug-Lindje, Lindje, Jugore dhe Veriore, të cilat fryjnë gjatë gjithë vitit. Erërat në drejtim Veri-Përendim në përgjithësi fryjnë në periudhën e verës, që shpesh kane dhe shpejtësi të madhe. Shpejtësia e erës në zonën në studim është në varësi të periudhës së vitit. Vlerat më të mëdha të tyre vërojnë në stinën e dimrit kur veprimtaria ciklonare është e theksuar. Rastisjen më të madhe e ka drejtimi juglindje me rastisje 15.8% dhe veriperëndimi me 15.1%.

Si përfundim mund të themi që klima është një faktor pozitiv duke krijuar kushte të përshtatshme për zhvillimin e pyjeve dhe të bimësisë në përgjithësi, por duhet theksuar se erërat e forta dhe reshjet e shumta të dëborës në këtë ekonomi bëjnë që të takohen drurë të rrëzuar nga erërat dhe jo rrallë edhe nga orteqet, të cilat thuajse janë periodikë në pjesën e sipërme të vegjetacionit pyjor. Në pjesën e sipërme të ekonomisë dhe zakonisht jashtë arealit të tyre takohen drurë të shtrembër që vijnë si pasoje e reshjeve të bores apo drejtimit të perhershëm të erërave.

IV.2 Topografia dhe morfologjia

Ekonomia Pyjore "Papadhi Çipin" shtrihet në lartësi të larmishme nga niveli i detit. Lartësia maksimale e ekonomisë prej 1700.3 m, arrihet në parcelën 65 në Malin e Cipinit, në Majën e Maceve. Ko është edhe pika ndarëse me bashkinë Tepelenë. Ndërsa lartësia minimale e kësaj ekonomie është 106 m, dhe përkon me fundin e parcelës Nr. 152, aty ku bashkohet përroi i Bolenës me lumin Shushicë.

Sipas tabelës së përllogaritjeve të dala nga punimet e zyrës (Tab. Nr. 6), grumbujt e ekonomisë pyjore Papadhi Çipin, kanë këtë shpërndarje sipas lartësisë mbi nivelin e detit:

- Në lartësinë 0-200 m shtrihen 16.7 ha ose 0.7% e grumbujve të kësaj ekonomie
- Në lartësinë 201-400 m shtrihen 915 ha ose 37.2% e totalit të grumbujve të ekonomisë
- Në lartësinë 401-600 m shtrihen 1174.8 ha me pyje ose 47.4% të totalit të grumbujve të ekonomisë.
- Në lartësinë 601-800 m shtrihen 228.4 ha me pyje ose 9.3% të totalit të grumbujve të ekonomisë.
- Në lartësinë 801-1000 m shtrihen 15 ha me pyje ose 0.6% të totalit të grumbujve të

ekonomisë.

- Në lartësinë 1001-1200 m janë të vendosura 43 ha me pyje ose 1.7% të totalit të grumbujve.

Sipërfaqja sipas lartësive mbi nivelin e detit dhe funksioneve kryesore

(përqindjet në lidhje me totalin e sipërfaqes sipas funksionit kryesor)

Ekonomia Pyjore : EP Papadhi-Çipin

Funksioni	0-200m		201-400m		401-600		601-800m		801-1000m		1001-1200m		1201-1400m		1401-1600m		1601-1800m		1801-2000m		>2000m		Total	
	ha	%	ha	%	ha	%	ha	%	ha	%	ha	%	ha	%	ha	%	ha	%	ha	%	ha	%	ha	%
Prodhues	16.7	0.7	915	37.2	1174.8	47.7	228.4	9.3	15	0.6	43	1.7	0	0.0	0	0.0	0	0.0	0	0.0	4.3	0.2	2462.9	

Tabela VI.2 Shtrirja e grumbujve sipas klasave të lartësisë së terrenit në EP Papadhi Çipin

Lartësia mesatare e ekonomisë pyjore Papadhi Çipin është 300 m mbi nivelin e detit.

Sa i takon kundrejtimit të përgjithshëm të ekonomisë, dominon kundrejtimi perëndimor, ndërsa për shkak të morfologjisë dhe thyerjeve të terrenit, të gjitha format e kundrejtimit gjenden në EP Papadhi Çipin.

Sipërfaqja sipas funksioneve kryesore dhe kundrejtmeve

Kundrejtimi	Sipërfaqja (ha)	% ndaj totalit të funksionit	% ndaj totalit të sipërfaqes pyjore
-------------	-----------------	------------------------------	-------------------------------------

Ekonomia : EP Papadhi-Çipin

Prodhues

Veri-Lindje	70.9	2.9	1.7
Lindje	154.2	6.3	3.6
Jug-Lindje	204.3	8.3	4.8
Jug	380.8	15.5	8.9
Jug-Perend	500.3	20.3	11.7
Perendim	884.9	35.9	20.6
Veri-Peren	243.2	9.9	5.7
Veri	24.3	1.0	0.6
Totali i funksionit :	2462.9	100.0	57.4

Mbrojtës

Veri-Lindje	190.8	10.4	4.4
Lindje	32.3	1.8	0.8
Jug-Lindje	68	3.7	1.6
Jug	244.9	13.4	5.7
Jug-Perend	433	23.7	10.1
Perendim	583.5	31.9	13.6
Veri-Peren	227.9	12.5	5.3
Veri	48.7	2.7	1.1
Totali i funksionit :	1829.1	100.0	42.6
TOTALI I EKONOMISE:	4292		100.0

Ashtu sikundër vërehet edhe nga tabela, kundrejtimi perëndimor zotëron në 1467 ha, ku 884 ha të ekonomisë ose 36% të totalit të saj janë grumbujt me funksion prodhues, ndërsa në grumbujt me funksion mbrojtës gjenden vetëm 584 ha ose 31.9% të totalit të sipërfaqes me këtë funksion. **Sa i takon pjerrësisë**, grumbujt e EP Papadhi Çipin janë të vendosur në pjerrësinë 11-40%, në një sipërfaqe prej 2193 ha ose në 97.1% të pyjeve me funksion prodhues. Në këtë kategori gjenden vetëm 66 ha të pyjeve me funksion mbrojtës ose 83% e shtreës me këtë funksion. Ndërsa në kategorinë e pjerrësisë 41-70%, kemi 252 ha me funksion prodhues dhe 1281 ha me funksion mbrojtës

Sipërfaqja sipas pjerrësisë dhe funksioneve kryesore

Funksioni	Sipërfaqja (ha)	% ndaj totalit të pjerrësisë	% ndaj totalit të sipërfaqes pyjore
<i>Ekonomia : EP Papadhi-Cipin</i>			
<u>11 - 40%</u>			
Prodhues	2193.6	97.1	51.1
Mbrojtës	66.1	2.9	1.5
Total :	2259.7		52.6
<u>41 - 70%</u>			
Prodhues	252.6	16.5	5.9
Mbrojtës	1281.7	83.5	29.9
Total :	1534.3		35.7
<u>71 -100%</u>			
Prodhues	16.7	3.4	0.4
Mbrojtës	481.3	96.6	11.2
Total :	498		11.6
TOTALI I EKONOMISE :	4292		

Tabela VI.2 Shtrirja e grumbujve sipas klasave të pjerrësisë së terrenit në EP Papadhi Çipin

Ndërsa në kategorinë 71-100% të pjerrësisë kemi vetëm 16.7 ha me pyje prodhues dhe 481 hajanë pyje me funksion mbrojtës.

Nga sa më sipër konkludojmë se sipërfaqja e pyjeve prodhues dominon në grupimin e parë më pjerrësi të terrenit 11-40%, ndërsa në kategorinë 41-70% pjerrësi të terrenit sipërfaqja zotërohet nga yjet mbrojtës, të cilët po ashtu dominojnë edhe kategorinë e tretë 71-100%. Nga kjo rezulton se pjerrësia e madhe e terrenit është faktor përcaktues i funksionit mbrojtës që kanë grumbujt e kësaj ekonomie.

IV.3 Gjeologjia

Grumbujt pyjorë të ekonomisë Papadhi Çipin, shtrihen në mbi 100% mbi formacione Gëlqerore. Formimi i tyre i përket Triasikut të sipërm dhe Jovasikut të poshtëm. Përfaqësimi i gëlqerorëve përbëhet nga nënlojet gëlqerorë me megalodontë, gëlqerorë stromatolitikë, dolomite dhe gëlqerorë radioloritikë me silicorë. Në vatra të vogla takohet edhe sistemi Kretarc, i përfaqësuar nga Kretaku i sipërm i pandove gëlqerorë me rendiste gëlqerore të dolomitizuar e gëlqerorë pllakorë. Këta formacione karakterizohen nga prania e shumë gurëve në sipërfaqe dhe në përgjithësi me toka skleretike dhe të thata.

Gëlqerorët e dolomitet në përgjithësi formojnë toka mesatare deri në të thella ku bëhet i mundur instalimi i llojeve të ndryshme të makies mesdhetare dhe dushqeve në këtë ekonomi, të tillë si

bunga, qarri, mareja dhe shqopa. Po ashtu vlen të theksohet se boniteti i këtyre formacioneve është mjaft i lartë dhe jep grumbuj të një cilësie të mirë.

IV.4 Tokat

Tokat e ekonomisë pyjore të marrë në studim shtrihen përgjithësisht në lartësi 150-1700 m mbi nivelin e detit (1700.3 - maja e Maceve) që bëjnë pjesë në brezin e dytë të zonalitetit vërtikal të tokave. Tokat e kësaj ekonomie si të gjitha tipet e tokave janë formuar dhe zhvilluar nën ndikimin e klimës, rilievit, të formacioneve shkëmbore dhe nën ndikimin e bimësisë ekzistuese. Në ekonominë pyjore "Papadhi Çipin", në bazë të klasifikimit F.A.O-UNESKO dallohen qartë tre tipe tokash, të cilat jepen të detajuara në tabelën nr. 11 në vijim. Tokat e hinjta kafe (Gray cinnamon) zënë pjesën kryesore të zonës së studimit. Ato zënë pjesën më të madhe të sipërfaqes dhe janë të vendosur mbi shkëmbinj gëlqeror ose sikurse njihen terminologjikisht mbi shkëmbinj karbonatik. Nga nentipet kryesore të këtyre tokave ndeshen:

Sipërfaqja sipas tipit të tokës dhe funksioneve kryesore			
Funksioni	Sipërfaqja (ha)	% ndaj totalit të tipit të tokës	% ndaj totalit të sipërfaqes pyjore
<i>Ekonomia : EP Papadhi-Çipin</i>			
<i>kafe</i>			
Prodhues	26.2	100.0	0.6
Total :	26.2		0.6
<i>murr.pyjore</i>			
Mbrojtes	39.3	100.0	0.9
Total :	39.3		0.9
<i>h.kafe</i>			
Prodhues	2413.1	69.3	56.2
Mbrojtes	1070.6	30.7	24.9
Total :	3483.7		81.2
<i>liv.mal.</i>			
Prodhues	23.6	3.2	0.5
Mbrojtes	719.2	96.8	16.8
Total :	742.8		17.3
TOTALI I EKONOMISE :	4292		

Tabela IV.4 Të dhëna tipet e tokës në EP Papadhi Çipin.

- (i) murrme pyjore;
- (ii) (ii) hinjta kafe dhe
- (iii) livadhore malore.

Përgjithësisht këto tipe tokash përfaqësojnë një profil të diferencuar, pasi ngjyra e horizontit të sipërm A është e zbehtë dhe horizonti B dhe C janë në ngjyrë gri në të verdhë. Përbërja mekanike (tekstura) është subargjilore e mesme. Sipas inventarizimit në sipërfaqet provë, trashësia e lëgushës dhe humusit kryesisht është më pak se 3 cm, dhe atje ku kalohet kjo trashësi, shkon nga 3 deri 5 cm.

Ashtu sikurse mund të vërehet edhe nga tabela më poshtë, tipi i tokave të hinjta kafe zotëron llojet e tokave në EP.

Për të patur një analizë të rifreskuar të rezultateve nga tokat e kësaj ekonomie, janë kryer analizat nga ekspertët e kontraktuar për këtë qëllim nga ku kanë rezultuar të dhënat e mëposhtme:

Ky relacion përfshin një analizë të përditësuar të karakteristikave të tokës në ekonominë pyjore ‘Papadhi Çipin’, bashkia Himarë dhe siguron rekomandime praktike për përmirësimin dhe menaxhimin e saj të qëndrueshëm.

Hyrje

Ekonomia pyjore “Papadhi Çipin” ndodhet në bashkinë Himarë dhe përfshin Njësia Administrative Horë Vranisht, duke mbuluar një gamë fshatrash, përfshirë Vranisht, Kuç, Kuç Buronjë, Bolenë, Kallarat, Tërbaç. Qëllimi kryesor i kësaj analize është vlerësimi i karakteristikave pedologjike të tokave të kësaj ekonomie pyjore në funksion të menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve, me synimin për të ndihmuar në ruajtjen e biodiversitetit dhe mbrojtjen e ekosistemeve pyjore.

Metodologjia

Përfshin këto aspekte kryesore: (i) Përzgjedhja e profilit të tokës sipas tipit mbizotërues të tokës (Tokat e kafenjta malore); (ii) Analiza e karakteristikave morfologjike në terren dhe atyre fiziko-kimike në laborator; (iii) Parametrat kryesorë: pH, përmbajtja e lëndës organike, azotit, fosforit, kaliumit dhe tekstura e tokës.

REZULTATET

Gjeologjia

Njësia Administrative Horë Vranisht. Zona karakterizohet nga një larmi shkëmbinjsh dhe formacionesh gjeologjike, ku përfshihen: (i) Shkëmbinj gëlqerorë; (ii) Ranorë dhe alevrolite të alternuara me argjila; (iii) Konglomerate të ndërthurura me gëlqerorë dhe argjila; dhe (iv) Formacione me përbërje gipsi, ranor, dhe alevrolite.

Tipet e tokave

Tipet e tokës (Sistemi Nacional i Klasifikimit, 1982) prezente në zonën e studimit janë: 1. Tokat e kafenjta malore; 2. Tokat e Hirta Kafe; 3. Tokat e Murrme Pyjore; 4. Tokat e Hirta Kafe Livadhore.

Veçoritë morfologjike

Tokat paraqiten mesatarisht te thella (rreth 0.5 m), duke përfshirë horizontet A, B dhe BC, përjashtojnë tokat në terrene shumë të pjerrëta dhe të eroduara, me ngjyrë kafe (7.5YR 5/4), teksturë të ekuilibruar argjilore, strukturë granulare, rrënjë të shumta në horizontin A dhe AB, fauna është e pranishme kryesisht në horizontet sipërfaqësore, toka nuk shkumëzon me HCl-10%. Toka ka cilësi të mirë në sipërfaqe, por kërkon menaxhim të kujdesshëm për të ruajtur pjellorinë dhe mbrojtjen ndaj erozionit.

Karakteristikat fiziko-kimike të tokës

- **pH:** Varion nga 4.92 në 6.02, duke treguar kushte bazike në thellësi dhe nevojë për menaxhim të fosforit.
- **Lënda organike dhe azoti:** Përmbajtja e karbonit total dhe azotit bie me thellësinë (2.40% dhe 0.21% në horizontin A deri 1.44% dhe 0.15% në B, respektivisht).
- **Fosfori dhe kaliumi:** Reduktim i ndjeshëm me thellësinë; kërkojnë ndërhyrje për përmirësimin e pjellorisë.
- **Tekstura:** Rërë 23–24%, lym 48–50%, argjilë 26–27%, që siguron ajrosje dhe mbajtje të ujit, por kërkon mbrojtje nga erozioni.

Tabela 1. Të dhëna fiziko-kimike të tokës (¹Gjoka, et al. 2011)

Nr, Profili	Horiz .	Thellesi a (cm)	pH (CaCl ₂)	CaCO ₃ %	P ₂ O ₅ * mg/100 gr	K ₂ O* mg/100 gr	C-tot al %	N-tot al %	Rër ë %	Ly m %	Argjil ë %
6	A	0-16	6.02	0.00	1.31	15.66	2.40	0.21	23.4	50.3	26.35
	AB	16-34	4.92	0.00	1.17	12.09	1.70	0.18	24.5	48.4	27.03
	B	34-58	4.93	0.00	1.17	8.58	1.44	0.15	-	-	-
	BC	58-75	5.22	0.00	1.17	8.42	1.72	0.16	-	-	-

*P₂O₅ dhe K₂O përfaqësojnë përmbajtjet e elementeve të shfrytëzueshme nga bimët.

Kufizimet Pedologjike

- Baziciteti i tokës: Kërkohet neutralizim i tokave më acidike (pH ≥ 5) në rast ripyllëzimi me lloje të ndjeshme ndaj aciditetit dhe për të rritur disponueshmërinë e fosforit dhe kaliumit.

- Erozioni: megjithëse nuk paraqiten terrene të tilla duhet paur kujdes nga shtresat argjilore në formë pllakash në thellësitë cilat bëhen shkak për rrëshqitje potenciale të tokës për shkak të përqindjes së lartë të lymit dhe argjilit.
- Lënda organike: Përmbajtje e ulët në thellësi, që ndikon negativisht në kapacitetin mbajtës të ujit.

Elemente të mbarështimit të pyjeve

- Përmirësim i përmbajtjes së lëndës organike dhe azotit në tokat e varfëra.
- Mbjellja e llojeve që i përshtaten kushteve të tokës dhe klimës së zonës.

IV.5 Rrjeti hidrologjik dhe burimet e furnizimit me ujë

Kushtet hidrogeologjike të territorit të zonës së studimit paraqiten në hartat hidrogeologjike të Shqipërisë në shkallë 1:200.000 dhe në atë me shkallë 1:100.000. Kjo zonë karakterizohet nga prania e dy tipeve shkëmbinjsh me karakteristika hidrogeologjike krejt të ndryshme: shkëmbinj gëlqerorë, dhe shkëmbinj flishorë. Shkëmbinjtë gëlqerorë përmbajnë rezerva të mëdha ujërash nëntokësore. Ata ndërtojnë pjesën perendimore të territorit dhe janë karakteristike për të gjithë ekonominë. Gëlqerorët kanë çarshmëri të lartë si dhe janë të karstëzuar gjë që manifestohet me hapësirat e mëdha karstike që ato përmbajnë si karie, hinka dhe shpella karstike. Si rezultat infiltrimi i rreshjeve atmosferike në to është i lartë, zakonisht mbi 50% e rreshjeve shkon për ushqimin e ujërave nëntokësore karstike.

EP Papadhi Çipin karakterizohet edhe nga prania e 1 lumi që prek territorin e saj:

Lumi i Shushicës i cili ka një gjatësi rreth 35 km dhe në pjesën e sipërme të tij formohet nga 4 degë: Përroi i Zi, përroi i Bolenës, përroi i Plihrës dhe përroi i Lithit. Të gjithë degët (përrenjtë) janë kryesisht të thatë dhe vetëm në stinën me reshje ato kanë ujë të rrjedhshëm. Kjo i dedikohet natyrës karstike të shkëmbinjve karbonikë që karakterizojnë zonën e studimit.

Po ashtu konturi i EP Papadhi Çipin mban në brendësi të saj një rrjet të pasur me burime ujore të cilat furnizojnë me ujë fshatrat e NJ.A. Horë-Vranisht. Ky rrjet burimesh është i pranishëm në pjesën fundore të ekonomisë përgjatë brigjeve të lumit Shushicë.

Si rezultat, konturi i EP Papadhi Çipin përbëhet nga eksistenca e një rrjeti hidrik të pasur dhe veçanërisht ai me Burime Ujore. Sa i takon rrjetit hidrik brenda ekonomisë (rreketë, prroskat apo përrenjtë) theksojmë se ato thuajse janë jo eksistent gjatë më shumë se gjysmës së vitit. Ato aktivizohen gjatë stinës me reshje dhe përgjithësisht nuk konsiderohen dhe as shkaktojnë ndonjë dëm sa i takon fenomenit të gërryerjes apo erodimit.

IV.6 Erozioni në sipërfaqet e pjerrëta dhe rrjedhat ujore

IV.7 Rrëshqitjet e tokës

Veshja e sipërfaqes së zonës së studimit me pyje, ka eliminuar tërësisht fenomenin e rrëshqitjes, pavarësisht territoreve të thepisura.

Nuk është konstatuar asnjë zonë problematike me rrëshqitje në të gjithë EP Papadhi Çipin.

V. Vegjetacioni dhe biodiversiteti

V.1 Brezat bio-klimatikë

Zona e studimit, për vetë pozicionin fiziko-gjeografik, karakterizohet nga ekzistenca e 3 brezave bio-klimatikë:

Në brezin e parë floristik i ashtëquajtur Brezi i Pyjeve dhe Shkurreve Mesofile, përfshihen të gjithë grumbujt pyjorë të vendosur kryesisht në rrëpirat gëlqerore të ekonomisë dhe kreshtat e luginat më të larta.


Ky brez bioklimatik karakterizohet nga prania e drurëve dhe shkurreve të cilat përfaqëohen nga

- a. Drurë halorë: Pisha e zezë dhe Bredhi i Maqedonisë,
- b. Drurë gjethegjëra rënëse: Mëlleza, Bunga, Panja e Malit, Krekëza dhe Dëllinja. Vendosen kryesisht mbi formacione gjeologjike gëlqerore, ku tokat janë mesatarisht të thella. Ky brez, për fat të keq vitet e fundit është nën presionin e ndryshimeve klimatike (rritja e temperaturave) të cilat po çojnë në cënimin e ekzistencës së llojeve dhe të ahut kryesisht.

Brezi i dytë bio-klimatik është ai i quajtur Brezi Riparian/Aluvial (Aneksi I I manualit të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave). Në fakt në hirearkinë e përhapjes llojore për nga lartësia mbi nivelin e detit, ky brez është brezi i parë. Ky brez bio-klimatik karakterizohet nga prania e drurëve të lartë, kryesisht të futur nëpërmjet pyllëzimeve sikurse ëshë Pisha e egër, ndërsa pjesa e mbeture bimësisë karakterizohet nga llojet shkurre të halorë të përfaqësuar nga dellinja e kuqe, ndërsa brezi i shkurreve fletore përbëhet nga llojet shqopë, mërsinë, xinë, lofatë.

Brezi i tretë bio-klimatik është ai i Pyjeve dhe Shkurreve Sklerofile të përherblerta, i cili në fakt është brezi që domimon të gjithë ekonominë pyjore të Papadhi Çipin, me njështrirje gjatësore që nga Bolena deri në Tërbaç. Ky brez karakterizohet nga prania e llojeve drunorë të introduktuar nga pyllëzimet dhe e karakterizuar nga pisha e egër. Sa i takon llojeve të tjera, përmendim shkurretat halore të përfaqësuar 100% nga dellinja e kuqe, dhe më pas kemi drurët sklerofil të përherblertë mesdhetarë të përfaqësuar nga Ilqja dhe Ullastra, për të kaluar në klasën e shkurreve mesofile të përherblerta të cilat përfaqësohen nga Prralli, Mareja, Shqopa, Xina, Xana, Dafina, Driza, Mreta, Sherebela, Gjineshtra dhe në disa raste edhe Shega e egër.

Si shkurre mesdhetare me gjethe gjithnjë të blerta dhe të lëkurta vlejné për t’u përmendur llojet: ilqja (*Quercus ilex*), xina (*Pistacia lentiscus*), mare (*Arbutus unedo*), shqopa (*Erica arborea*), mersina (*Myrtus communis*), gjineshtra (*Spartium junceum*), morenxa (*Smilax aspera*) si dhe bimë që i lëshojné gjethet gjatë dimrit si driza (*Paliurus aculeatus*), frashëri (*Fraxinus ornus*), shkoza (*Carpinus orientali*) etj. Flora e bimësisë barishtore e formacionit të makjes në përgjithësi është e varfër dhe monotone për shkak të mbulesës së dendur të saj. Ajo është e pasur edhe me bimë të ulëta kriptogame, si Likenet (*Lichenes*) – mbi trungjet dhe gurët, Briofitet (*Bryophyta*), në tokë, drurë ose gurë, Fierera, (*Pteridophyta*), Kërpudha (*Mycophyta*).



Duke qenë se basenet ujëmbledhës në zonën e Himarës përfaqësohen nga një rrjet hidrik i pasur, pavarësisht origjinës ata paraqesin një ekosistem interesant veçanërisht për larminë biologjike të tyre. Në këto basene ujëmbledhes rritet një bimësi ujëdashëse dhe me lloje me tolerancë të lartë ekologjike. Në brendësi të tyre ndodhen disa lloje algash makrofite të gjelbërta (*Chlorophyta*) si (*Ulothrix*, *Chara*, *Spirogyra* etj). si dhe disa bimë fanerogame si *Myriophyllum verticillatum*, *Potamogeton crispus* L., *Alisma plantago* – *aquatica* L. *Nymphaea alba*, *Nuphar luteum*, *Typha angustifolia* B.et Ch. *Alisma plantago* – *aquatica* L. *butomus umbellatus* L. *Carex pendula* Huds., *Carex extensa* Good., *Cyperus longus* L., *Scirpus holoschoenus* L., *Juncus glaucus* Ehrh. Etj

V.2 Pyjet dhe kullotat

Ashtu si më sipër kemi theksuar, Ekonomia Pyjore “Papadhi Çipin” përbëhet nga 4292 ha me pyje dhe nga 1252 ha kullota, të gjitha në pronësi bashkiake. Në total, sipërfaqja pyjore e EP Papadhi Çipin është 6858 ha, por në këtë pikë do të ndalemi vetëm tek forma e përdorimit pyje dhe kullota. Për pyjet në pronësi private nuk është paraqitur informacion, pasi në përcaktimet ligjore thuhet se plani i Mbarështimit për pyjet hartohen nga pronarët, kështu që plani i Mbarështimit për këto sipërfaqe do të duhet të hartohet nga pronarët dhe më pas ai është pjesë integrale e EP Papadhi Çipin.

Sa i takon sipërfaqes kullosore, theksojmë se përgjithësisht janë kullota të vendosura mbi formacione skeletike karbonike (gëlqerorësh) dhe ndikohen shumë shpejt nga thatësira dhe periudha pa reshje në stinën e verës. Gjatë inventarizimit në terren vërehet se kullotat shfytëzohen pak vetëm në stinën e pranverësh dhe gjatë verës apo vjeshtës nuk ka prezencë të bagëtisë. Kjo mbase për distancën e largët nga qendrat e banuara apo dhe humbjen e interesit të

V.3 Tipet pyjore

Dallohen 13 tipe pyjore në të gjithë konturin e EP Papadhi Çipin, të cilat paraqiten si në tabelën më poshtë:

Tipi i Grumbullit	Total ha I %		Funksioni							
			Prodhues		Mbrojtës		Rekreacion		Konservim	
	ha	I %	ha	I %	ha	I %	ha	I %	ha	I %
<i>Ekonomia pyjore : EP Papadhi-</i>										
Pyje me bredh te maqedonise	120	2.8	0	0.0	120	2.8	0	0.0	0	0.0
Pyje me pishe te zeze	203.5	4.7	0	0.0	203.5	4.7	0	0.0	0	0.0
Pyje pishe te zeze me dushqe	151.3	3.5	16.7	0.4	134.6	3.1	0	0.0	0	0.0
Pyje me makie	424.5	9.9	422.5	9.8	2	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje me pishe te eger	26.6	0.6	26.6	0.6	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje me prall	2278.2	53.1	1646	38.4	632.2	14.7	0	0.0	0	0.0
Pyje me ilqe	798	18.6	178.2	4.2	619.8	14.4	0	0.0	0	0.0
Pyje me qarr	14.8	0.3	14.8	0.3	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje qarri me dushqe te tjere	15.1	0.4	15.1	0.4	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje me shpardh	6.6	0.2	6.6	0.2	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje shpardhi me dushqe te tjere	5.8	0.1	5.8	0.1	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje me bungbute	99.1	2.3	99.1	2.3	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje me bunge	148.5	3.5	31.5	0.7	117	2.7	0	0.0	0	0.0
TOTALI I EKONOMISE:	4292	100.0	2462.9	57.4	1829.1	42.6	0	0.0	0	0.0

Tipi i pyllit që dominon në EP Papadhi Çipin, është tipi: **"Pyje me prall"** me një sipërfaqe të përgjithshme prej 2278 ha, nga të cilat 1646 ha ose 38% e këtij tipi janë të vendosur në pyje me funksion prodhues, ndërsa pjesa tjetër prej 632 ha janë të vendosur në grumbujt me funksion mbrojtës.

Grupi i dyti më i madh është ai i tipit **"Pyje me ilqe"**, i cili zë një sipërfaqe të përgjithshme prej 798 ha, nga ku 178 ha janë pjesë e grumbujve me funksion mbrojtës dhe pjesa tjetër prej 620 ha janë pjesë e grumbujve të zonave të mbrojtura.

"Pyje me makie" që zë 424 ha ose 9.9% të sipërfaqes totale të ekonomisë. Ky tip pylli zotëron thuajse të gjithë sipërfaqen me formë qeverimi "shkurre" dhe ndodhet thuajse 100% në grumbujt me funksion prodhues. Karakterizohet nga prania e llojeve mare, shqopë, driza, ullastër, xina,

xana, ilqja dhe prall e valanidh më rrallë. Megjithatë, kudo është vërejtur përzierja edhe me shkozën, qarrin apo bungën, të cilat nëse grumbulli do të vazhdojë të mbetet në "qetësi" (pa kullotje dhe pa ndërhyrje), ka shumë gjasa që ai të zotërohet nga këta lloje.

"Pyje me pishë të zezë" është grupimi tjetër më i madh në sipërfaqen e EP Papadhi Çipin, i cili zë në sipërfaqe prej 204 ha dhe është i gjithi pjesë e grumbujve me funksion mbrojtës. Lloji kryesor është pisha e zeze, natyrale dhe e vendosur në shpate me pjerrësi shume të madh në disa raste mbi 71%.

"Pyje me pishë të zezë me dushqe", është një grupim tjetër në rend i cili shtrihet në 151 ha të kësaj ekonomie. Karakterizohet nga prania e dy llojeve ai i pishës së zezë dhe prrallit, kryesisht të dy llojet në formën e qeverimit trungishte. Edhe ky grupim pyjor shtrihet thuhetse 100% në grumbujt me funksion mbrojtës.

"Pyje me bungë" dhe "Pyje me bungëbutë", zënë përkatësisht 148 dhe 99 ha në totalin e EP. Shtrihen thuhetse 100% në grumbujt pyjor me funksion prodhues.

"Pyjet me bredh të maqedonisë", shtrihen në 120 hektarë të EP dhe gjenden 100% brenda grumbujve me funksion mbrojtës.

Për tipet e tjera ekziston informacioni si në tabelën më sipër dhe të cilët pavarësisht ekzistencës së tyre nuk kanë ndonjë peshë specifike në ekonomi.

V.4 Tipet e kullotave

Sipërfaqja kullosore në EP Papadhi Çipin shtrihet në një sipërfaqe relativisht të madhe prej 1252 ha e cila gjendet në pllajën gëlqerore që fillon nga luginat mbi fshatin Bolenë e përfundon në Tërbaç. Për nga vetë natyra e tyre, lartësia mbi nivel deti dhe përbërja floristike ato kategorizohen si kullota verore. Detaje në tabelën më poshtë.

Tipi i kullotës	Sipërfaqja ha	% e totalit të sipërfaqes kullosore	% e totalit të së zonës së studimit
Kullotë verore	1252	100	18
Totali	1252	100%	18

Të vendosura mbi formacione karbonike dhe mbi toka skeletike ato e vuajnë thatësirën, megjithatë në pranverë dhe verën e hershme janë shumë të pasura me lloje dhe shumë të ushqyeshme për blegtorinë. Nga diskutimet me banorët vendas, pas viteve 2024, kullota ka një rënie të ndjeshme. Më parë ajo frekuentohej nga blegtorë të cilët shfrytëzonin kullotën në stinën

e verës. Mungesa e rrugëve (tashmë edhe ajo e kafshëve është totalisht e prishur dhe as kalimi i tyre nuk mundëset), por edhe rënia e ndjeshme e interesit të banorëve të zonës për të mbarështuar blegtori, ka bërë që kjo kullotë të lihet nën suksesionin natyror dhe së shpejti vendin e saj ka shumë gjasa që ta zënë stadi të tjera më të avancuara të bimësisë.

Duke qenë se nuk ka asnjë lloj interesi nga ana e banorëve, nuk është planifikuar asnjë punim apo masë për mbrojtjen e përmirësimin e saj.

V.5 Tipet e vegjetacionit potencial

Nëntë janë tipet e vegjetacionit potencial të evidentuara në EP Papadhi Çipin:

Tipi i vegjetacionit potencial të stacionit i cili përfaqëson stadin më të avancuar të zhvillimit dhe **gjenezës në EP Papadhi Çipin, është ai i "Formacioni pyjor i Pinus nigra"**. Megjithëse me një sipërfaqe jo të vogël prej 343 ha dhe me vështirësi të mbijetesës për shkak të ndryshimeve klimaterike, ai vazhdon të konsiderohet si stadi më i avancuar i vegjetacionit në këtë ekonomi. Megjithëse është zonë krejt e përshtatshme për zhvillimin e këtij tipi, numri i llojit përfaqësues nga e cila merr edhe emrin shtresa pyjore, është në rënie të ndjeshme. Kjo ka ardhur si rezultat i ngritjes së temperaturave mesatare vjetore në areal, duke e vënë në vështirësi mbijetesën e këtij lloji, kryesisht për shkak të nivelit të ulët të lagështisë ajrore dhe zjarreve frekvente. Sa vjen e më shumë kjo shtresë po zëvendësohet nga llojet e tjera si mëlleza, krekeza, panja e malit dhe shkoza e frasheri i zi. Ky tip vegjetacioni nuk përputhet me vegjetacionin aktual, që përkthehet se llojet nuk e shfrytëzojnë bonitetin që ofron areali, por kjo vjen si pasojë e ndryshimeve klimaterike dhe ndërhyrja për ta vendosur atë ndryshuar tipin e vegjetacionit është e pamundur. Të mbetet nën suksesionin natyror, ky është rekomandimi i shprehur në objektivat e këtij plani mbarështimi.

Tipet e vegjetacionit potencial sipas funksioneve/ perqindja ndaj totalit të siperfaqes pyjore

Tipi i vegjetacionit	Total ha I %		Funksioni							
			Prodhues ha I %		Mbrojtes ha I %		Rekreacion ha I %		Konservim ha I %	
Ekonomia pyjore : EP Papadhi-										
Formacioni pyjor i Bredhit te Maqedonise	120	2.8	0	0.0	120	2.8	0	0.0	0	0.0
Formacione pyjore te Pinus nigra Arnold,subsp.Pallasiana	343.2	8.0	16.7	0.4	326.5	7.6	0	0.0	0	0.0
Formacion pyjor ballkanik. Pinus peuce	11.6	0.3	0	0.0	11.6	0.3	0	0.0	0	0.0
Formacion druresh te shparthit	12.4	0.3	12.4	0.3	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Formacion pyjor. Quercus petraea	178.4	4.2	61.4	1.4	117	2.7	0	0.0	0	0.0
Formacion drunor i Quercus pubescens Wild. E Carpinus orientalis	2189	51.0	1260.3	29.4	928.7	21.6	0	0.0	0	0.0
Formacioni dushkajash i Quercus pubescens Wild., Ulmus minor Miller	7.9	0.2	0	0.0	7.9	0.2	0	0.0	0	0.0
Formacione shkurre me Myrtus comunis L.Pistacia lentiscus L.	334.2	7.8	334.2	7.8	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Formacione shkurre te Quercus ilex L. dhe Quercus coccifera L.	1095.3	25.5	777.9	18.1	317.4	7.4	0	0.0	0	0.0
TOTALI I EKONOMISE :	4292	100.0	2462.9	57.4	1829.1	42.6	0	0.0	0	0.0

Një formacion tjetër pyjor i cili paraqitet i avancuar për nga stadi llojor, është ai i **"Formacion pyjor i Bredhit të Maqedonisë"**, i cili për fat të keq edhe ky është në minimumin jetik të tij në këtë ekonomi. I shtrirë në një sipërfaqe prej 120 ha, ai përfaqëson formën e qeverimit trungishte në EP Papadhi Çipin. Nëse grumbujt vazhdojnë të mbeten nën qetësinë aktuale, ka shumë gjasa që kjo shtresë të dominojë në një të ardhme jo të largët EP. Në objektivat e këtij plani mbarështimi është sygjëruar dhe synohet që një pjesë e mirë e sipërfaqeve pyjore të shkojnë drejt një stadi më të avancuar të formës së qeverimit.

"Formacioni pyjor i Quercus pubescens", zotëron tipin e vegjetacionit potencial në EP Papadhi Çipin. Ai shfaqet në dy stade të tij, në formacionin drunor dhe në atë shkurre, ku grupimi drunor zotëron sipërfaqen. Ajo që kuptohet është se potenciali i stacionit është formacioni drunor dhe stadi i degraduar është ai shkurre. Lloji kryesor dhe që dominon këtë grupim është prralli, kryesisht në formën e qeverimit cungishte dhe trungishte.

"Formacioni shkurre i Quercus ilex" është formacioni i cili zë vendin e tretë të rëndësishëm në formacionet vegjetative me potencial prodhues në EP. Ai dominohet nga llojet prrall dhe ilqe në formën e qeverimit shkurre, dhe në këtë stad pa prespektivë rimëkëmbje.

Formacioni pyjor potencial i Myrtus communis (makia) renditet i katërti në EP Papadhi Çipin me një sipërfaqe prej 334 ha ose rreth 7.8% të totalit të ekonomisë. Sigurisht që shfrytëzon maksimalisht potencialin e vegjetacionit si formacion, por duhet patjetër të shndërrohet në një formë qeverimi më të avancuar me synimin për të rritur prodhimtarinë dhe për të shfrytëzuar

maksimalisht binitetin e stationit ku vegjeton. Përfqëson 100% formën e qeverimit shkurre aktualisht dhe llojet përbërëse të tij ashtu sikurse kemi theksuar më sipër janë ato karakteristike të makies të tilla si mareja, shqopa, xina, xana, krifça, driza, ullastrat, ilqja, valanidhi, por në shumë raste të përziera edhe me dushqe, shkozë e frashër.

V.6 Biodiversiteti

Biodiversiteti në EP Papadhi Çipin, ndonëse i rrezikuar për shkak të shfaqjes së fenomeneve gjithnjë e në rritje të zjarreve, paraqitet ende i larmishëm. Vetë shtrirja gjeografike e EP garanton kushte për larmishmëri të tij.

Në zonën para-bregdetare ku shtrihet edhe EP Papadhi Çipin, konsiderohen si oaze të ruajtjes së natyrës dhe larmisë biologjike të vendit. Sot në këtë zonë bëjnë pjesë ekosisteme të larmishme përfshirë ato malore të mbuluara me pyje, kullota e sidomos ato ligatinore që përfshijnë laguna, liqene, lumenj, ujëra bregdetare, pyje bregdetare, pyje breglumore, duna ranore, toka me bimësi të kripur, shkurreta, pyje etj. Ky brez strehon ndërkaq thuajse tërësinë e specieve të natyrës shqiptare ku shumë prej specieve dhe habitateve janë në mbrojtje nga konventat ndërkombëtare, Direktivat e Komunitetit Evropian dhe nga legjislacioni shqiptar në fushën e mbrojtjes së natyrës.

Zona e studimit është një vend i pasur me habitate e cila renditet në 30 % të florës së vendit tonë. Koncepti habitat lidhet me biodiversitetin, i cili është tërësia e organizmave të gjallë dhe ekosistemeve ku këto organizma zhvillohen. Këto habitate përfshijnë laguna, liqene, lumenj, ekosisteme detare e bregdetare. Biodiversiteti është i rëndësishëm pasi është faktor që ndikon në rritjen e turizmit në vend si dhe ruajtjen e rëndësisë së specieve të veçanta. Megjithatë, mbrojtja e biodiversitetit është e vështirë të realizohet për shkak të kompleksitetit të tij dhe veçorive të habitateve.

Vlen të theksohet se vitet e fundit në zonën e studimit ka pasur ndryshime të këtyre ekosistemeve dhe për rrjedhojë edhe ndryshim të popullatave të specieve apo zhdukje të tyre. Disa faktorë që kanë ndikuar në këtë shndërrim janë: ndotja ujore dhe akustike, fragmentimi i habitateve, gjuetia e paligjshme, grumbullimi i bimëve në menyrë të paligjshme, ndryshimet klimatike, përmbytjet, thatësira, zjarret në pyje. E thënë ndryshe, speciet e kanë të vështirë përshtatjen me mjediset e reja dhe si rrjedhojë popullatat e tyre reduktohen ndjeshëm deri në zhdukje nga mungesa e kushteve optimale që lidhen me habitatin, ushqimin apo sëmundjet e ndryshme. Disa grupe janë më shumë të rrezikuara nga të tjerët pasi habitatin e tyre është shkatërruar plotësisht si rrjedhje e ndotjes që lidhet drejtpërdrejt me nivelin e lartë të urbanizimit, ashtu si dhe me zjarret në pyje, apo peshkimit të paligjshëm.

V.7 Prania e vlerave të larta mbrojtëse

Pllaja gëlqerore e thepisur e EP Papadhi Çipin paraqet një interes të veçantë për t'u marrë në konsideratë. Rënia e popullatës së bredhit të maqedonisë dhe mungesa e ripërtëritjes natyrale, përbën një zonë me interes kërkimor për të ndjekur ecurinë e zhvillimit të tij dhe për të nxjerrë konkluzione. Për më tepër kjo zonë thuhet se është në kushtet e një qetësie natyrore, duke garantuar një oaz tërësisht natyror pa praninë e efekteve humane, për shkak të mungesës së rrugëve. Ndjekja e ecurisë së zhvillimit të grumbujve të kësaj zonë, do të ishte me interes shkencor jo vetëm për institucionin e bashkisë Himarë, por pse jo edhe për ato kërkimore të tilla si Fakulteti i Pyjeve apo i Shkencave Natyrore.

V.8 Rreziku për biodiversitetin dhe efektet mbi planifikimin

Efektet e planifikimit të objektivave të këtij plani mbarështimi nuk kanë asnjë efekt mbi biodiversitetin. I vetmi shqetësim mbetet rritja e temperaturave mesatare vjetore të cilat ashtu sikurse është vërejtur, po shkaktojnë mutacione të fuqishme në popullatën e pishës së zezë dhe atë të bredhit të maqedonisë të gjendura në kurorën e thepisur të EP Papadhi Çipin.

V.9 Mundësitë për aktivitete didaktike dhe kërkimore

Zona e studimit përgjatë kurorës së thepisur të EP paraqet interes të veçantë për t'u mbajtur në konsideratë sa i takon aktiviteteve didaktike apo atyre kërkimore. Tkurrja e popullatës së bredhit dhe pishës së zezë në këtë zonë e cila mendohet se e ka origjinën nga ndryshimet klimaterike (rritja e temperaturave mesatare vjetore dhe ulja e lagështisë ajrore) paraqet një interes të veçantë për kërkime, duke mbajtur parasysh faktin që kjo zonë është jashtë ndikimit human për arsye të mos-eksistencës së rrugëve hyrëse. Studimi i situatës aktuale dhe propozimi i masave për adaptim do të ishte me mjaft interes jo vetëm për zonën por edhe për të gjithë zonat me kondicione klimatike e tokësore të ngjashme.

VI. ANALIZIMI I TË DHËNAVE PËR PYJET DHE KULLOTAT

VI.1 Analizimi i të dhënave për pyjet

VI.1.1 Analizimi i tipeve pyjore

Ashtu si më sipër kemi theksuar, ndër 13 tipet e pyjeve që janë evidentuar në ekonominë pyjore Papadhi Çipin, tipi i pyjeve që dominon, është tipi i pyjeve "Pyje me prall".

Tipi i Grumbullit	Total ha I %		Funksioni							
			Prodhues ha I %		Mbrojtes ha I %		Rekreacion ha I %		Konservim ha I %	
Ekonomia pyjore : EP Papadhi-										
Pyje me b redh te maqedonise	120	2.8	0	0.0	120	2.8	0	0.0	0	0.0
Pyje me pishe te zeze	203.5	4.7	0	0.0	203.5	4.7	0	0.0	0	0.0
Pyje pishe te zeze me dushqe	151.3	3.5	16.7	0.4	134.6	3.1	0	0.0	0	0.0
Pyje me makie	424.5	9.9	422.5	9.8	2	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje me pishe te eger	26.6	0.6	26.6	0.6	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje me prall	2278.2	53.1	1646	38.4	632.2	14.7	0	0.0	0	0.0
Pyje me ilqe	798	18.6	178.2	4.2	619.8	14.4	0	0.0	0	0.0
Pyje me qarr	14.8	0.3	14.8	0.3	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje qarri me dushqe te tjere	15.1	0.4	15.1	0.4	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje me shpardh	6.6	0.2	6.6	0.2	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje shpardhi me dushqe te tjere	5.8	0.1	5.8	0.1	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje me bungbute	99.1	2.3	99.1	2.3	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje me bunge	148.5	3.5	31.5	0.7	117	2.7	0	0.0	0	0.0
TOTALI I EKONOMISE:	4292	100.0	2462.9	57.4	1829.1	42.6	0	0.0	0	0.0

Tipi i pyllit që dominon në EP Papadhi Çipin, është tipi: **"Pyje me prall"** me një sipërfaqe të përgjithshme prej 2278 ha, nga të cilat 1646 ha ose 38% e këtij tipi janë të vendosur në pyje me funksion prodhues, ndërsa pjesa tjetër prej 632 ha janë të vendosur në grumbujt me funksion mbrojtës.

Grupi i dyti më i madh është ai i tipit **"Pyje me ilqe"**, i cili zë një sipërfaqe të përgjithshme prej 798 ha, nga ku 178 ha janë pjesë e grumbujve me funksion mbrojtës dhe pjesa tjetër prej 620 ha janë pjesë e grumbujve të zonave të mbrojtura.

"Pyje me makie" që zë **424 ha** ose 9.9% të sipërfaqes totale të ekonomisë. Ky tip pylli zotëron thujtë të gjithë sipërfaqen me formë qeverimi "shkurre" dhe ndodhet thujtë 100% në grumbujt me funksion prodhues. Karakterizohet nga prania e llojeve mare, shqopë, driza, ullastër, xina, xana, ilqja dhe prall e valanidh më rrallë. Megjithatë, kudo është vërejtur përzierja edhe me shkozën, qarrin apo bungën, të cilat nëse grumbulli do të vazhdojë të mbetet në "qetësi" (pa kullotje dhe pa ndërhyrje), ka shumë gjasa që ai të zotërohet nga këta lloje.

"Pyje me pishë të zezë" është grupimi tjetër më i madh në sipërfaqen e EP Papadhi Çipin, i cili zë në sipërfaqe prej 204 ha dhe është i gjithi pjesë e grumbujve me funksion mbrojtës. Lloji kryesor është pisha e zeze, natyrale dhe e vendosur në shpate me pjerrësi shume të madh në disa raste mbi 71%.

"Pyje me pishë të zezë me dushqe", është një grupim tjetër në rend i cili shtrihet në 151 ha të kësaj ekonomie. Karakterizohet nga prania e dy llojeve ai i pishës së zezë dhe prrallit, kryesisht të dy llojet në formën e qeverimit trungishte. Edhe ky grupim pyjor shtrihet thuhetse 100% në grumbujt me funksion mbrojtës.

"Pyje me bungë" dhe "Pyje me bungëbutë", zënë përkatësisht 148 dhe 99 ha në totalin e EP. Shtrihen thuhetse 100% në grumbujt pyjor me funksion prodhues.

"Pyjet me bredh të maqedonisë", shtrihen në 120 hektarë të EP dhe gjenden 100% brenda grumbujve me funksion mbrojtës.

Për tipet e tjera ekziston informacioni si në tabelën më sipër dhe të cilët pavarësisht ekzistencës së tyre nuk kanë ndonjë peshë specifike në ekonomi.

VI.1.2 Shpërndarja e sipërfaqes dhe volumit sipas regjimit të qeverisjes

Sikurse më sipër kemi theksuar, forma e qeverimit në të gjithë sipërfaqen pyjore, është e klasifikuar sipas tabelës në vijim:

FORMA E QEVERISJES

Forma e qeverisjes	Aktuale		E propozuar	
	Sipërfaqja ha	%	Sipërfaqja ha	%
<i>Ekonomia : EP Papadhi-Çipin</i>				
Trungishte	1310.2	30.5	1310.2	30.5
Cungishte	1257.6	29.3	1570.8	36.6
Trung. e parregullt	29.4	0.7	29.4	0.7
Cung. e perbere	271.4	6.3	39.2	0.9
Shkurre	1423.4	33.2	1342.4	31.3
Livadh	0.0	0.0	0.0	0.0
Kullote	0.0	0.0	0.0	0.0
Kullote me drure	0.0	0.0	0.0	0.0
Kullote me shkurre	0.0	0.0	0.0	0.0
Total:	4292.0		4292.0	

Në Total:




Tabela VII.1.1. Forma e qeverimit në EP Papadhi Çipin.

Pas përpunimit të dhënave në programin Access, sipërfaqja, volumi dhe forma e qeverisjes kanë korelacionin si në vijim:

Analiza tipit të grumbullit nga llogaritjet për n/ngastrat (Trungishte)

	<u>Kl moshes</u>	<u>Sip ha</u>	<u>m2/ha</u>	<u>Td</u>	<u>Nr dr/ha</u>	<u>Volumi</u>	<u>rritja vij</u>		
						<u>m3/haTotm3</u>	<u>m3/ha</u>	<u>Totm3</u>	
<i>Ekonomia Pyjore : EP Papadhi-Cipin</i>									
Trung	Pyje me bredh të maqedonise								
	121-140vjec	67.1	24.25	0.62	166	82.85	5559.2	1.60	107.60
	141-160vjec	52.9	16.48	0.50	155	139.55	7382.3	0.68	35.91
	Totali i shtreses:	120.0	20.82	0.57	161	107.85	12941.5	1.20	143.51
Trung	Pyje me pishe të zeze								
	81-100vjec	11.6	10.01	0.31	175	84.44	979.5	1.50	17.41
	121-140vjec	18.1	19.71	0.50	196	177.43	3211.5	0.25	4.56
	141-160vjec	173.8	22.53	0.58	191	192.35	33430.4	0.15	26.43
	Totali i shtreses:	203.5	21.56	0.56	190	184.87	37621.4	0.24	48.40
Trung	Pyje pishe të zeze me dushqe								
	121-140vjec	93.6	26.14	0.81	347	209.13	19574.1	2.26	211.71
	141-160vjec	57.7	20.94	0.56	263	186.66	10770.5	1.36	78.32
	Totali i shtreses:	151.3	24.16	0.72	315	200.56	30344.7	1.92	290.03
Trung	Pyje me pishe të eger								
	41-60vjec	26.6	31.76	1.32	498	158.39	4213.1	9.71	258.18
	Totali i shtreses:	26.6	31.76	1.32	498	158.39	4213.1	9.71	258.18
Trung	Pyje me prall								
	41-60vjec	67.0	13.62	0.96	374	92.45	6194.2	2.15	143.79
	61-80vjec	12.0	13.32	0.98	441	90.51	1086.2	1.96	23.50
	101-120vjec	26.9	27.88	1.97	287	195.21	5251.2	4.75	127.80
	141-160vjec	25.7	14.87	1.07	404	73.96	1900.8	2.34	60.12
	Totali i shtreses:	131.6	16.75	1.19	368	109.67	14432.3	2.70	355.21
Trung	Pyje me ilqe								
	1-20 vjec	6.4	0.57	0.04	800	0.00	0.0	0.15	0.99
	41-60vjec	322.0	13.05	0.63	264	83.15	26775.2	2.05	659.10
	101-120vjec	44.9	11.43	0.55	257	90.74	4074.4	1.65	73.97
	121-140vjec	31.1	8.61	0.46	250	58.75	1827.1	1.56	48.66
	141-160vjec	32.1	25.80	1.19	232	22.66	727.2	3.78	121.38
	Totali i shtreses:	436.5	13.32	0.65	268	76.53	33404.0	2.07	904.10
Trung	Pyje me shpardh								
	141-160vjec	6.6	10.45	0.40	87	74.77	493.5	2.09	13.79
	Totali i shtreses:	6.6	10.45	0.40	87	74.77	493.5	2.09	13.79
Trung	Pyje shpardhi me dushqe të tjere								
	141-160vjec	5.8	25.87	1.20	550	32.06	186.0	4.64	26.94
	Totali i shtreses:	5.8	25.87	1.20	550	32.06	186.0	4.64	26.94
Trung	Pyje me bungbute								
	41-60vjec	7.6	14.92	1.03	125	119.88	911.1	2.48	18.85
	121-140vjec	4.8	9.24	0.58	86	72.07	345.9	1.80	8.65
	141-160vjec	74.2	10.73	0.61	168	85.70	6359.1	1.97	146.34
	Totali i shtreses:	86.6	11.02	0.64	160	87.95	7616.0	2.01	173.84
Trung	Pyje me bunge								
	41-60vjec	96.7	15.01	1.01	296	108.86	10527.2	3.04	293.97
	121-140vjec	25.2	20.26	1.29	200	151.15	3809.1	4.99	125.80
	141-160vjec	19.8	5.21	0.34	209	39.03	772.9	0.98	19.48
	Totali i shtreses:	141.7	14.57	0.97	266	106.63	15109.1	3.10	439.25
	Totali i ekonomise:	1310.2	17.28	0.74	259	119.34	156361.6	2.03	2653.25

Tabela VII.1.2. Të dhëna për volumin e llogaritur në formën e qeverimit trungishte në EP Papadhi Çipin

Për pyjet me formë qeverimi trungishte, volumi i ërgjithshëm është 156 361 m³, i shpërndarë në një sipërfaqe prej 1310 ha. Volumi mesatar 119 m³/ha.

Nga ky total, 85'121 m³ janë volum i cili vjen nga halorët (Pisha e egër, pishë e zezë dhe bredhi i maqedonisë) dhe pjesa tjetër prej 71 240 m³, vjen nga fletorët. Volumi për fletorët është i përqendruar tek lloji ilqe në masën 33'404 m³ dhe pjesa tjetër prej 14'432 m³ dhe 15'109 m³, prodhohet përkatësisht nga llojet prall dhe bungë. Theksojmë se pjesë e këtij volumi janë edhe volumi për llojet mëlleza dhe shkozë, të cilat për shkak të mungesës së tabelave të kubaturës për këta lloje, janë llogaritur si panja. Të dhëna të detajuara tabela VII.1.2

Për pyjet me formë qeverimi cungishte, nga përpunimi i të dhënave sipas programit Access, rezulton që të jetë kjo panoramë:

Analiza tipit të grumbullit nga llogaritjet për n/ngastrat (Cungishte)

	<u>Kl moshes</u>	<u>Sip ha</u>	<u>m2/ha</u>	<u>Td</u>	<u>Nr dr/ha</u>	<u>Volumi</u> <u>m3/haTotm3</u>	<u>rritja vij</u> <u>m3/ha Totm3</u>		
<i>Ekonomia Pyjore : EP Papadhi-Cipin</i>									
Cungishte thj.	Pyje me makie								
	11-20vjec	8.9	3.46	0.38	867	16.60	147.7	1.07	9.49
	21-30vjec	2.0	1.86	0.14	1250	8.50	17.0	0.52	1.04
Totali i shtreses:		10.9	3.17	0.34	937	15.11	164.7	0.97	10.53
Cungishte thj.	Pyje me prall								
	21-30vjec	499.6	6.17	0.53	1015	29.25	14610.8	1.45	723.86
	31-40vjec	336.4	8.92	0.71	937	53.16	17882.6	1.80	606.40
	41-50vjec	39.5	10.84	0.82	1267	66.28	2618.1	1.69	66.73
Totali i shtreses:		906.4	7.18	0.59	963	38.74	35111.5	1.54	1396.99
Cungishte thj.	Pyje me ilqe								
	11-20vjec	28.8	1.62	0.15	500	8.12	234.0	0.53	15.26
	21-30vjec	82.0	5.56	0.36	680	33.24	2725.9	1.36	111.29
	31-40vjec	163.7	6.35	0.38	639	38.76	6345.7	1.26	206.63
	41-50vjec	25.6	5.27	0.27	360	32.89	842.1	0.86	22.10
Totali i shtreses:		300.1	5.59	0.34	613	33.81	10147.6	1.18	355.28
Cungishte thj.	Pyje me qarr								
	31-40vjec	12.6	9.19	0.47	439	72.53	913.9	1.59	20.08
Totali i shtreses:		12.6	9.19	0.47	439	72.53	913.9	1.59	20.08
Cungishte thj.	Pyje qarri me dushqe të tjere								
	31-40vjec	15.1	11.72	0.73	1250	70.58	1065.7	2.45	37.00
Totali i shtreses:		15.1	11.72	0.73	1250	70.58	1065.7	2.45	37.00
Cungishte thj.	Pyje me bungbute								
	41-50vjec	12.5	12.64	0.76	275	95.18	1189.7	2.42	30.22
Totali i shtreses:		12.5	12.64	0.76	275	95.18	1189.7	2.42	30.22
Totali i ekonomise :		1257.6	6.90	0.53	870	38.64	48593.2	1.47	1850.09

Tabela VII.1.3 Të dhënat e llogaritur për formën e qeverimit cungishte

Për pyjet në formën e qeverimit shkurre, programi MS Access DB, nuk llogarit të dhëna, kjo pasi baza e të dhënave që përdoren për llogaritje është ndërtuar mbi tabelat e kubaturës. Por volumi është llogaritur duke u mbështetur në një formulë me mesatarizim për llojet fletorë (sikurse në

fakt janë të gjitha llojet). Fillimisht është llogaritur volumi për secilin individ : $V = 3.14 * (d_m/2)^2 * h * k_f$, ku V – volumi i një indiviti; d_m – diametri mesatar ne 1.3 m nga lartësia e tokës; h – lartësia e mesatarizuar për n/parcelë k_f – koeficienti i formës = 0.9.

Duke qene se per $d_m < 3$ cm dhe $h < 3$ m, volumi për secilin individ është shumë i vogël, kemi kryer llogaritje vetem për $d_m \geq 3$ cm dhe për $h \geq 3$ m.

Vëllimi mesatar i llogaritur për secilin individ (dru) është shumëzuar me numrin e drurëve/ha, dhe është marrë një volum mesatar për hektarë.

Për sa më sipër, konkludojmë se volumi i përgjithshëm në shtresën e formës së qeverimit "Shkurre" në total ekonomie është 4668 m³, dhe me një mesatare prej afro 3 m³/ha.

Në formë të përmbledhur për të gjithë ekonominë Papadhi Çipin, volumi i ndarë sipas formës së qeverimit jepet në tabelën VII.1.4, më poshtë

Regjimi i qeverisjes	Sipërfaqja (ha)	Volumi mesatar (m ³ /ha)	Volumi i përgjithshëm në këmbë (m ³)
Trungishte	1310	119.3	156361
Cungishte	1257	38.64	48593
Shkurre	1423	3	4668
Gjithsej	4292	48.84	209'622

Tabela VII.1.4 Volumi i përgjithshëm i EP Papadhi Çipin.

Ashtu sikurse mund të vërehet nga të dhënat e tabelës më sipër, EP *Papadhi Çipin* ka një volum të përgjithshëm prej 209'622m³, me një volum mesatar prej 48.84 m³/ha.

VI.1.3 Struktura e pyjeve sipas klasave të moshës dhe klasave të prodhimtarisë së stacionit

Struktura e pyjeve sipas klasës së moshës dhe të prodhimtarisë së stacionit është një tregues sinjifikativ i një EP, pasi mbi bazën e këyij korelacioni shikohet dhe llogaritet vijimësia e prodhimit dhe mbarështimi i qëndrueshëm në një EP.

Për të qenë më konkret në pasqyrimin e këtij indikator, ky korelacion do të veçohet për secilën formë qeverimi. Kështu për pyjet me formë qeverimi trungishte me funksion mbrojtës ekziston korelacioni si në tabelën VI.1.3.1.

Nr.	Klasa e moshës (vjet)	Volumi (m ³)	Klasa e prodhimit
1	I (0 - 20 vjet)	0	-
2	II (21 - 40 vjet)	2'850	5
3	III(41 - 60 vjet)	10'340	4
4	IV (61 - 80 vjet)	0	-
5	V (81 - 100 vjet)	1'569	4
6	VI (101-120 vjet)	2'335	5
7	VII (121 – 140 vjet)	30'179	5
8	VII (141 – 160 vjet)	75'851	5
TOTALI		123'124	5

Tabela VI.1.3.1 Shpërndarja e volumit sipas klasave të moshës në trungishten me funksion mbrojtës.

Për pyjet trungishte me funksion Mbrojtës, programi MC Access DB nuk paraqit të dhëna për shkak të ngarkesës dhe volumit në këtë kategori. Të dhënat janë marrë n/parcelë për n/parcelë nga tabela 22/6.

Shenojmë se:

- Iloji i koduar LI është ekuivalent në llogaritje dhe përfaqëson llojin PRRALL, pasi për këtë lloj tabelat e kubatures mungojnë dhe programi nuk llogarit të dhëna.**
- Mosha 45 vjet për të gjitha dushqet pa përjashtim, në formën e qeverimit TRUNGISHTE, është ekuivalente me moshën 140 vjet, dhe përkon me llojet, Prrall, Ilqe, Bungebute dhe Bunge. Programi MCAccess DB, nuk llogarit volum për kategorinë e dushqeve të sipërcituara, për mosha me të mëdha se 45 vjet,**

Përqendrimi i volumit në klasën e VII të moshës (141-160 vjet) por që [përkon kryesisht me moshën reale 145 vjeç, është volumi i cili rrjedh nga pyjet me funksion mbrojtës, të vendosura në rrepi të thepisura në kreshtën e malit Çipin. Volumi është i përqendruar kryesisht në llojet Pishë e Zeze, Bredh, Panje fletegjerë, Prrall, Bungebutë, Bunge që të gjithë në formën e qeverimit trungishte. Megjithatë kanë humbur volum të konsiderueshëm për shkak të zjarreve, për seri këto formacione pyjore vazhdojnë të rezistojnë.

Sa i takon lidhjeve të klasave të moshës me klasën e prodhimit të stacionit, për pyjet trungishte me funksion prodhues, pejen në tabelën VI.1.3.2

Shpërndarja e sipërfaqes dhe vëllimit sipas klasave të moshës (Trungisht prodhuese)

<u>Lloji</u>	<u>Kl moshes</u>	<u>Sip ha</u>	<u>Volumi</u>	
		<u>%ndr</u>	<u>%vol</u>	<u>Totm3</u>
<i>Ekonomia Pyjore : EP Papadhi-Cipin</i>				
41-60vjec				
BN		0.0	7.6	911.1
BRB		0.0	2.3	241.1
BUN		0.0	4.9	242.6
IL		0.0	58.7	5440.5
LI		0.0	12.6	1168.9
MA		0.0	0.4	30.8
PAF		0.0	5.6	532.1
PIE		0.0	25.2	4007.5
61-80vjec				
LI		0.0	12.0	1086.2
101-120vjec				
LI		0.0	26.9	5251.2
121-140vjec				
BN		0.0	4.8	345.9
IL		0.0	3.4	876.8
PIZ		0.0	13.3	3390.1
141-160vjec				
BN		0.0	59.3	5068.4
BUN		0.0	17.9	735.5
IL		0.0	4.6	439.5
LI		0.0	34.8	2293.2
MA		0.0	3.0	132.7
PAF		0.0	6.0	549.4
SHP		0.0	6.6	493.5
Totali i ekonomise :			309.7	33236.9

Tabela VI.1.3.2. Korelacioni midis, klasave të moshës, sipërfaqes dhe vëllimit për pyjet me formë qeverimi trungishte me funksion prodhues.

Lidhje midis klasave të moshës, vëllimit dhe klasës së prodhimit të stacionit, në trungishtet prodhuese jepet në tabelën VI.1.3.3 më poshtë.

Shperndarja e sipërfaqes dhe vëllimit sipas klases se prodhimit (Trungishte prodhuese)

<u>Lloji</u>	<u>Kl.prod</u>	<u>Sipërfaqe</u>	<u>Volumi</u>
<i>Ekonomia Pyjore : EP Papadhi-Cipin</i>			
BN		71.7	6325.4
	2	28.5	2634.9
	3	35.1	2731.3
	4	8.1	959.3
BRB		2.3	241.1
	5	2.3	241.1
BUN		22.8	978.0
	3	22.8	978.0
IL		66.7	6756.8
	3	12.2	1054.6
	4	3.4	876.8
	5	51.1	4825.5
LI		86.2	9799.5
	4	41.9	6384.9
	5	44.3	3414.6
MA		3.4	163.5
	4	0.3	26.5
	5	3.1	136.9
PAF		11.6	1081.5
	4	5.6	532.1
	5	6.0	549.4
PIE		25.2	4007.5
	3	8.7	1236.2
	4	16.5	2771.3
PIZ		13.3	3390.1
	4	13.3	3390.1
SHP		6.6	493.5
	3	6.6	493.5
	5	0.0	0.0
Totali i ekonomisë :		309.7	33236.9

Tabela VI.1.3.3 Korelacioni midis volumit dhe klasës së prodhimit në pyjet trungishte me funksion prodhues.

Në formën e qeverimit CUNGISHTË kemi këtë panoramë:

- a. Cungishte me funksion mbrojtës

Për cungishtet me funksion mbrojtës lidhja midis klasave të moshës, klasave të prodhimit dhe volumit, kanë këtë korelacion:

Shpërndarja e sipërfaqes dhe vëllimit sipas klasave të moshës (Cungishte mbrojtëse)

<u>Lloji</u>	<u>Kl moshes</u>	<u>Sip ha</u>	<u>Volumi</u>
	<u>%ndr</u>	<u>%vol</u>	<u>Totm3</u>
<i>Ekonomia Pyjore : EP Papadhi-Cipin</i>			
21-30vjec			
IL	0.0	81.2	2632.0
LAB	0.0	0.4	20.4
LI	0.0	140.9	4681.0
MA	0.0	2.1	26.0
MER	0.0	2.6	99.7
31-40vjec			
BUN	0.0	12.0	455.5
IL	0.0	124.6	5311.8
LI	0.0	107.8	5568.8
MA	0.0	3.5	109.3
MER	0.0	1.2	40.7
PAF	0.0	0.9	31.6
41-50vjec			
IL	0.0	24.5	784.5
LI	0.0	0.2	10.7
PAF	0.0	0.9	46.9
Totali i ekonomise :		533.7	19819.1

Tabela VI.1.3.4 Korelacioni midis sipërfaqes, volumit dhe klasave të moshës në pyjet cungishte më funksion mbrojtës.

Ndërsa klasat e prodhimit me sipërfaqen dhe volumin në cungishte me funksion mbrojtës, kanë korelacinin e paraqitur në tabelën ***VI.1.3.5 më poshtë.***

Shpërndarja e sipërfaqes dhe vëllimit sipas klasave të prodhimit (Cungishte mbrojtëse)

<u>Lloji</u>	<u>Kl prodh.</u>	<u>Sipër</u>	<u>ha</u>	<u>Volumi</u>
		<u>%ndr</u>	<u>%vol</u>	<u>Totm3</u>
<i>Ekonomia Pyjore : EP Papadhi-Çipin</i>				
IL		0.0	81.2	2632.0
	5	0.0	81.2	2632.0
LAB		0.0	0.4	20.4
	5	0.0	0.4	20.4
LI		0.0	140.9	4681.0
	5	0.0	140.9	4681.0
MA		0.0	2.1	26.0
	5	0.0	2.1	26.0
MER		0.0	2.6	99.7
	5	0.0	2.6	99.7
BUN		0.0	12.0	455.5
	5	0.0	12.0	455.5
IL		0.0	124.6	5311.8
	5	0.0	124.6	5311.8
LI		0.0	107.8	5568.8
	5	0.0	107.8	5568.8
MA		0.0	3.5	109.3
	5	0.0	3.5	109.3
MER		0.0	1.2	40.7
	5	0.0	1.2	40.7
PAF		0.0	0.9	31.6
	5	0.0	0.9	31.6
IL		0.0	24.5	784.5
	5	0.0	24.5	784.5
LI		0.0	0.2	10.7
	5	0.0	0.2	10.7
PAF		0.0	0.9	46.9
	5	0.0	0.9	46.9
Totali i ekonomisë :			533.7	19819.1

b. Cungishte me funksion prodhues

Për cungishtet me funksion prodhues paraqitet korelacioni si në tabelën më poshtë:

Shperndarja e siperfaqes dhe vellimit sipas klasave te moshes (Cungishte prodhuese)

<u>Lloji</u>	<u>Kl moshes</u>	<u>Sip ha</u>	<u>Volumi</u>
	<u>%ndr</u>	<u>%vol</u>	<u>Totm3</u>
<i>Ekonomia Pyjore : EP Papadhi-Cipin</i>			
11-20vjec			
IL	0.0	22.8	185.8
MA	0.0	14.9	195.9
21-30vjec			
BN	0.0	6.5	618.0
IL	0.0	18.5	530.8
LI	0.0	283.9	7416.4
MA	0.0	19.0	469.6
MER	0.0	4.1	75.0
QA	0.0	22.6	727.7
SHZ	0.0	1.9	57.1
31-40vjec			
BUN	0.0	0.9	33.8
IL	0.0	27.4	964.0
LAB	0.0	0.1	1.7
LI	0.0	218.9	11780.3
MA	0.0	1.8	58.5
MER	0.0	2.5	94.8
QA	0.0	25.8	1747.4
SHZ	0.0	0.3	9.5
41-50vjec			
BN	0.0	10.8	1023.8
IL	0.0	1.5	140.0
LI	0.0	39.0	2584.9
MA	0.0	0.8	59.1
Totali i ekonomise :		723.9	28774.1

Tabela VI.1.3.6 Lidhja midis klasave të mosës, vëllimit dhe sipërfaqes ne cungishtet me funksion prodhues.

Lidhje midis sipërfaqes, volumit dhe klasave të prodhimit të stacionit në cungishtet me funksion prodhues, jepet në tabelën VI.1.3.7 më poshtë.

Shpërndarja e sipërfaqes dhe vëllimit sipas klasave të prodhimit (Cungishte prodhuese)

<u>Lloji</u>	<u>Kl prodh.</u>	<u>Sip ha</u>	<u>Volumi</u>	
		<u>%ndr</u>	<u>%vol</u>	<u>Totm3</u>
<i>Ekonomia Pyjore : EP Papadhi-Çipin</i>				
BN		0.0	17.2	1641.8
	2	0.0	7.2	690.0
	4	0.0	10.0	951.8
BUN		0.0	0.9	33.8
	5	0.0	0.9	33.8
IL		0.0	70.2	1820.6
	5	0.0	70.2	1820.6
LAB		0.0	0.1	1.7
	5	0.0	0.1	1.7
LI		0.0	541.7	21781.6
	4	0.0	9.2	710.5
	5	0.0	532.5	21071.1
MA		0.0	36.5	783.0
	5	0.0	36.5	783.0
MER		0.0	6.6	169.8
	5	0.0	6.6	169.8
QA		0.0	48.4	2475.1
	5	0.0	48.4	2475.1
SHZ		0.0	2.3	66.6
	5	0.0	2.3	66.6
Totali i ekonomise :			723.9	28774.1

Sa më sipër konkludojmë se klasa e prodhimit të stacionit mbi të cilat shtrihen grumbujt pyjorë në EP Papadhi Çipin janë kryesisht në klasën e V të bonitetit.

Edhe për pyjet në formën e qeverimit cungishte, llojet e saj bëjnë pjesë në klasën e V të prodhimit dhe vëllimi është po i njëjtë 1452.6 m³.

Sa i takon formës së qeverimit shkurre, tabela në vijim paraqet lidhjet (korelacionin midis, sipërfaqes, klasës së moshës, klasës së prodhimit dhe vëllimit respektiv.

Nr.	Klasa e moshës (vjet)	Sipërfaqja (ha)	Volumi (m ³)	Klasa e prodhimit
1	I (0-5 vjet)	114	0	-

2	II (6-10 vjet)	171	0	-
3	III (11-15 vjet)	213	607	5
4	IV (16-20 vjet)	356	1400	5
5	V (21-25 vjet)	569	2661	5
TOTALI		1423	4668	5

Tabela VII 1.1 Lidhja midis sipërfaqes, klasave të moshës, klasave të prodhimit dhe vëllimit në pyjet më formë qeverimi shkurre në EP Papadhi Çipin

Ashtu sikurse vërehet edhe nga tabela më sipër, pyjet në formën e qeverimit shkurre, janë klasifikuar në 4 klasa moshe, ku dominon klasa e III e moshës (11-15 vjet), me një sipërfaqe prej 1086.2 ha dhe me një volum prej 1194 m³. Ndërkohë theksojmë se pyjet në klasat e moshës I (0-5 vjet) dhe në klasën e II të moshës (6-10 vjet) nuk posedojnë volum të llogaritshëm për shkak të karakteristikave dendrometrike të vogla. Ndërsa në klasën e IV të moshës, në një sipërfaqe prej 683 ha kemi të vendosur një volum prej 1177 m³. Po ti referohemi sipërfaqes, në pamje të parë duket se ka një korelacion të drejtë të shpërndarjes së volumit me sipërfaqen, por në fakt volumi më i madh është i përqendruar në klasën e IV të moshës.

Si konkluzion theksojmë se korelacioni midis klasave të moshës, sipërfaqes dhe shpërndarjes së vëllimit në EP Papadhi Çipin nuk garanton vijueshmërinë e prodhimit dhe as një menaxhim të qëndrueshëm të fondit pyjor. Për këtë qëllim është shumë e rëndësishme që pikë së pari të respektohen masat e planifikuara për t'u aplikuar përgjatë 10 viteve në vijim, ku ndër më kryesoret është tendenca për të konvertuar grumbujt pyjorë në një formë qeverimi më të avancuar. Nëpërmjet kësaj do të synohet edhe një shpërndarje e volumit në përpjesëtim të drejtë me madhësinë e sipërfaqes dhe klasat e moshës, duke synuar normalizimin e fondit. Sigurisht që kjo kërkon një kohë e cila nuk mund të arrihet vetëm përgjatë afatit ligjor të këtij plani mbarështimi, por normalizimi mund të arrihet për 50 vjet.

VI.2 Analizimi i të dhënave për kullotat

VI.2.1 Gjendja e kullotave

Ashtu si më sipër kemi theksuar, kullota në EP Papadhi Çipin shtrihet në vetëm 1252 ha. Sa i takon sipërfaqes kullimore, theksojmë se ajo është e pranishme thuajse përgjatë të gjithë ekonomisë pyjore. Ajo është pjesë përbërëse e saj dhe vendoset kryesisht në kurorën e ekonomisë. Përgjithësisht janë kullota të vendosura mbi formacione skeletike karbonike (gëlqerorësh) dhe ndikohen shumë shpejt nga thatësira dhe periudha pa reshje në stinën e verës. Gjatë inventarizimit në terren vërehet se kullotat shfrytëzohen pak vetëm në stinën e pranverës dhe

gjatë verës apo vjeshtës nuk ka prezencë të bagëtisë. Kjo mbase për distancën e largët nga qendrat e banuara apo dhe humbjen e interesit të pupullsisë vendase për të mbarështuar bagëti. Sipas vendasve më parë kullota është shfrytëzuar me stane përgjatë periudhës Qershor-Tetor, por që pas viteve 1998, një traditë e tillë nuk ekziston. Ndërkohë që në qendër dhe në afërsi të vendeve ku janë ndërtuar stanet ekziston një lërë e cila është në gjendje të mirë aktualisht dhe ku është burimi i vetëm për ujëpirje për kafshët e egra që jetojnë në këtë lloj rrafshnalte të izoluar.

Habitati I ketyre kullotave konsiderohet mjaft i pasur me lloje të cilat dominohen nga shoqërimet me: *Poa media-Festucetum panciana*, *Cynosuro-Trifolietum pratense*, *Phleum alpinum-Koeleretum splendens* dhe *Asphodeletum albus-Narcissus poeticus*.

Llojet treguese të tij janë: *Campanula glomerata*, *Carex spp.*, *Carex viridula*, *Centaurea jacea*, *Crocus veluchensis*, *Fritillaria macedonica*, *Hieracium cymosum agg.*, *Taraxacum officinale*, *Trifolium repens*, *Viola aetiolica* and *Anthoxanthum odoratum*, *Koleria pyramidata*, *Sesleria comosa*, *Trisetum flavescens* etj.

VI.2.2 Madhësia dhe vendndodhja e sipërfaqes kullosore

Ashu si më sipër theksuam, sipërfaqja kullosore e EP Papadhi Çipin është 1252 ha. Ajo shtrihet në parcelat që konturojnë pjesën jllindire dhe jugore të EP. Toponimi popullor njihet me emrin Mali i Çipinit.. Kullotat janë përdorur historikisht pa kufizime nga fshatrat në afërsi të saj, të tillë si Bolena, Brati, Tërbaçi, etj. Aktualisht sipërfaqja kullosore shfrytëzohet edhe nga barinj të tjerë që shtegtojnë në fillim të pranverës drejt zonës.

VI.2.3 Altituda, pjerrësia, kundrejtimi dhe kushtet hidrologjike

Kullotat janë të vendosura në pjesën fundore të Malit të Çipinit dhe përfaqësojnë pjesën më të thyer të tij. Altituda mbi të cilat shtrihen ato është 1300-1700.3 m mbi nivelin e detit. Kundrejtimi i përgjithshëm i tyre është Jug-Perëndimor.

Të vendosura mbi formacione karbonike (gëlqerorë), prania e rrjetit hidrik është inekzistente. Aktualisht ka vetëm një lërë e cila mbulesht nga reshjet. Gjendja e saj është krahasimisht e mirë, duke mbajtur parasysh që ajo ka rreth 1 dekadë që nuk përdoret dhe për rrjedhojë as mirëmbahet. Aktualisht ajo shërben si burim uji vetëm për kafshët e egra.

VI.2.4 Mbërritshmëria

Sipërfaqja kullosore nuk ka mbërritshmëri dhe për fat të keq as ajo me kafshë nuk është më funksionale. Të mbërrish në këtë pllajë "në çatinë e botës" ka vetëm një shëg, dikur i përshtatur

për të kaluar edhe kafshët e barrës, por që me kalimin e viteve edhe ai është dëmtuar për shkak të rënies së Maceve duke e bërë totalisht të pakalueshëm edhe për to. Mos-kërkesa për kullotje, bën që kullota të mbetet në gjendje të qetë, duke e rrezikuar asimilimin e saj nga bimësia shkurre e më pas edhe ajo drunore.

VI.2.5 Mbledhja e të dhënave për sipërfaqet e djegura në kullota

Gjatë vërtetimit në terren dhe inventarizimit të zonës së studimit janë vërejtur fenomene të zjarrit të 4-5 viteve me parë, kryesisht në malin e Gamtit e cila ka atakuar edhe kullotën. Aktualisht nuk ka shenja të zjarrit, megjithatë problem për këtë zonë mbeten shkarkesat natyrore (rrufete) të cilat janë shkaktari kryesor për rënien e zjarreve. Distanca e largët nga zonat e banuara dhe mungesa e rrugëve dhe shtigjeve e rrishton shumë kullotën nga zjarri.

VII. REZULTATET E INVENTARIZIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

VII.1 Rezultati i inventarizimit në pyje

VII.1.1 Analiza statistikore e inventarizimit të pyjeve

Inventarizimi i Ekonomisë Pyjore Papadhi Çipin, pyje dhe kullota është mbështetur në manualin "Për hartimin e planeve të menaxhimit për pyjet dhe kullotat", miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit me shkresën Nr. 864 Prot, datë 30.01.2019. Ai u bazua në matjet e sipërfaqeve provë të përhershme dhe të përkohshme të vendosura sipas një rrjeti të baraslarguar sistematik për shkak se ka avantazhe jo vetëm në aspektin e saktësisë, por gjithashtu në vlerësimin e ndryshimit të të dhënave në pyje nëpërmjet krahasimit midis inventarizimeve të njëpasnjëshme. Gjithsej, mbështetur në statusin e pyjeve/kullotave të regjistruara për EP Papadhi Çipin, u ndërtuar rrjeti i cili përbëhet nga 2164 sipërfaqe provë. Për shkak të ndryshimeve të vërejtura në terren, janë vendosur rreth 120 sipërfaqe provë të tjera të shënuara me koordinata, por të cilat konsiderohen si të përkohshme për shkak se janë jashtë rrjetit 200 x 200 m. Ky rrjet sipërfaqesh provë ka sjellë evidencë si për tokat jopyjore ashtu edhe për pronat pyjore, të cilat nuk dihet se për çfarë shkaqesh kanë mbetur pa u regjistruar.

Përdorimi i tokës	Nr. i sipërfaqeve provë të përhershme	Nr. i sipërfaqeve provë të përkohshme
Pyll	1785	120
Kullotë	334	0

Sipërfaqe jo pyjore (djerr)	2	0
E pambërritshme	43	
Gjithsej	2164	120

Inventarizimi i pyjeve u krye në ndërthurje me ortofotot me rezolucion të lartë si një mjet për ndërtimin e rrjetit dhe shpërndarjes së sipërfaqeve provë. Përveç kësaj, vendndodhjet e sipërfaqeve provë u përcaktuan gjithashtu edhe në hartat topografike, të cilat së bashku me ortofotot u përdorën nga ekipet e terrenit për të kompletuar inventarizimin.

Metodologjia e përdorur për ngritjen e rrjetit të sipërfaqeve provë ishte e njëjtë me atë të specifikuar në Udhëzuesin e PMPK të vitit 2019. Matjet u kryen në tre rrathë bashkëqendrorë në sipërfaqet provë, me sipërfaqe 25 m², 200 m² dhe 400 m², në mënyrë që të përfshiheshin të gjitha kategoritë diametrike të drurëve (1.3 m nga toka) në grumbujt pyjorë. Në sipërfaqen provë 25 m² u mblodhën të dhëna për ripërtëritjen natyrore dhe u matën drurët, diametri bazimetrik i të cilëve ishte nga 2 cm deri 7.5 cm. Sipërfaqet provë me këtë madhësi, u përdorën gjithashtu edhe për inventarizimin e kullotave dhe në vlerësimin e prodhimeve pyjore jodrusore. Në sipërfaqen e dytë provë (200 m²) u matën drurët me diametër bazimetrik nga 7.51 cm deri 27.5 cm dhe në sipërfaqen e tretë provë (400 m²) u matën vetëm drurët me diametër më të madh se 27.5 cm. Për të vlerësuar saktësinë e inventarizimit të pyjeve bazuar në volumin e përlogaritur për secilën sipërfaqe provë, ne vlerësuam parametrat e mëposhtëm:

- Shmangia standard e volumit ndërmjet sipërfaqeve provë;

$$S_x = \pm \sqrt{S_x^2} \quad S_x^2 = \frac{\sum_{i=1}^n x_i^2 - \frac{(\sum_{i=1}^n x_i)^2}{n}}{n-1}$$

- Koeficienti i variacionit të volumit ndërmjet sipërfaqeve provë;

$$S_{x\%} = \frac{S_x}{x} \cdot 100$$

- Gabimi standard në metër kub dhe përqindje;

$$S_{\bar{x}} = \frac{S_x}{\sqrt{n}}$$

Bazuar në këto ekuacione ne vlerësuam saktësinë e volumit ndërmjet sipërfaqeve provë dhe gjetëm që gabimi standard në llogaritjen e volumit ishte 5.9%. Ky gabim është jodomethënës, që do të thotë se të dhënat e volumit të siguruara nga inventarizimi në terren janë brenda kufirit të gabimit ($\pm 20\%$).

Numri i sipërfaqeve provë Ph + Pk	2164+120
-----------------------------------	----------

Volumi mesatar (m ³ /ha)	48.98
Shmangia standard	105.6
Koeficienti i variacionit	165.4
Gabimi standard (m ³)	7.2
Gabimi standard (%)	6.1

VII.1.2 Volumi dhe rritja në volum e grumbujve pyjorë

Nga inventarizimi i grumbujve të EP Papadhi Çipin, rezulton një volum drusor në këmbë prej 209'622 m³ (meter kub), të vendosura në sipërfaqe pyjore prej 4292 ha, dhe me një volum mesatar për ha prej afro 49 m³/ha. Tabelat më poshtë paraqesin të dhëna të detajuara për volumin në këmbë, volumin mesatar, rritjet mesatare vjetore dhe rritjen vijuese, në korelacion me sipërfaqen, moshën dhe bonitetin e grumbullit, të ndara sipas llojeve, të gjetur nga inventarizimi i grumbullit në terren dhe nga përpunimi i të dhënave në zyrë me programin microsoft access. Ashtu si më sipër kemi theksuar, për formën e qeverimit shkurre, volumet janë llogaritur mbi bazën e ekuacioneve të volumit, dhe për pasojë në tabelën përmbledhese nuk pasqyrohen rritjet mesatare apo ato vijuese.

Nga sa më sipër, vërehet se i gjithë volumi në këmbë prej 209 '622 m³, kategorizohet në lëndë punimi dhe dru zjarri.

Shumica e këtij volumi, ktyesisht për pyjet trungishte vjen nga sipërfaqet pyjore që kanë funksion mbrojtës dhe i dedikohet llojeve Pishë e Zezë, Bresh, Panjë fletëgjërë, Bungëbutë, Bungë, Prrall e Ilqe, të gjitha këta me formë qeverimi trungishte.

Referuar formës së qeverimit dhe funksioneve të grumbujve pyjorë ekziston korelacioni si në tabelën më poshtë:

Forma e qeverimit		Volumi (në m ³) sipas Funksionit		TOTALI
		Prodhues	Mbrojtës	
1	Trungishte	33'237	123'124	156'361
2	Cungishte	28'774	19'819	48'593
3	Shkurre	4668	0	4668
TOTALI		66'679	142'943	209'622

Ashtu sikundër mund të shikohet volumi i dedikohet grumbujve me funksion ,brojtës, të gjetur të tillë nga plani i mëparshëm dhe të mbetur më funksion të tillë për shkak të sipërfaqeve mjaft të pjerrëta ku mbi 50% e tyre janë me pjerrësi mbi 70% dhe pjesa tjetër variojnë në intervalin e pjerrësisë 55-70%.

VII.1.3 Struktura vertikale

Struktura vertikale e grumbujve të EP Papadhi Çipin, është kryesisht me 2 kate, por vërehen edhe pyje me 3 kate. Pyjet me tre kate janë vërejtur në parcelat me funksion mbrojtës kryesisht, ku nga

trungishtet e moçme të "vetëtrajtura" ke,i të bëjmë më një trungishte kopshtore, ku diferencohen të tre katet dhe te tre jane kate drunore të mirëfillta. Një gjë e tillë është evidentuar nëpërmjet punës së inventarizimit nëpërmjet sipërfaqeve provë në terren, nga ku nuk vërehen diferencime të kateve të bimësisë.

Panorama për të gjithë ekonominë jepët në tabelën në vijim:

Struktura vertikale e grumbullit

		Struktura	Ha	%
<i>Ekonomia Pyjore : EP Papadhi-Cipin</i>				
Cung.perb.	Prodhuës			
Pyje me p rall			240.2	91
	Dy kate		145.9	61
	Tre kate		94.3	39
Pyje me ilqe			20.6	8
	Dy kate		20.6	100
Pyje me qarr			2.2	1
	Dy kate		2.2	100
	Totali i shtreses :		263	
Cung.perb.	Mbrojtes			
Pyje me p rall			8.4	100
	Dy kate		8.4	100
	Totali i shtreses :		8.4	
Cungishte thj.	Prodhuës			
Pyje me makie			8.9	1
	Nje kat		8.9	100
Pyje me p rall			602.3	83
	Nje kat		72.1	12
	Dy kate		503.8	84
	Tre kate		26.4	4
Pyje me ilqe			72.5	10
	Nje kat		25.4	35
	Dy kate		47.1	65
Pyje me qarr			12.6	2
	Nje kat		2	16
	Dy kate		10.6	84
Pyje qarri me dushqe te tjere			15.1	2
	Dy kate		15.1	100
Pyje me bungbute			12.5	2
	Dy kate		12.5	100
	Totali i shtreses :		723.9	
Cungishte thj.	Mbrojtes			
Pyje me makie			2	0
	Nje kat		2	100
Pyje me p rall			304.1	57
	Nje kat		239.1	79
	Dy kate		65	21
Pyje me ilqe			227.6	43
	Nje kat		32.7	14
	Dy kate		194.9	86
	Totali i shtreses :		533.7	
Trung.parreg.	Prodhuës			
Pyje me ilqe			22.6	77
	Dy kate		22.6	100
Pyje me bunge			6.8	23
	Dy kate		6.8	100
	Totali i shtreses :		29.4	
Trung	Prodhuës			
Pyje pishe te zeze me dushqe			16.7	5
	Nje kat		16.7	100
Pyje me pishe te eger			26.6	9
	Nje kat		16.5	62
	Dy kate		10.1	38

Pyje me prall		80.2	26
	Nje kat	27.6	34
	Dy kate	52.6	66
Pyje me ilqe		62.5	20
	Nje kat	49.9	80
	Dy kate	12.6	20
Pyje me shpardh		6.6	2
	Nje kat	6.6	100
Pyje shpardhi me dushqe te tjere		5.8	2
	Dy kate	5.8	100
Pyje me bungbute		86.6	28
	Nje kat	32.1	37
	Dy kate	47.7	55
	Tre kate	6.8	8
Pyje me bunge		24.7	8
	Nje kat	4.9	20
	Tre kate	19.8	80
	Totali i shtreses :	309.7	
Trung	Mbrojtes		
Pyje me bredh te maqedonise		120	12
	Nje kat	6.9	6
	Dy kate	113.1	94
Pyje me pishe te zeze		203.5	20
	Nje kat	191.9	94
	Dy kate	11.6	6
Pyje pishe te zeze me dushqe		134.6	13
	Dy kate	134.6	100
Pyje me prall		51.4	5
	Nje kat	41	80
	Dy kate	10.4	20
Pyje me ilqe		374	37
	Nje kat	228.8	61
	Dy kate	145.2	39
Pyje me bunge		117	12
	Nje kat	99.5	85
	Dy kate	17.5	15
	Totali i shtreses :	1000.5	
Shkurre	Prodhues		
Pyje me makie		413.6	36
	Nje kat	413.6	100
Pyje me prall		723.3	64
	Nje kat	723.3	100
	Totali i shtreses :	1136.9	
Shkurre	Mbrojtes		
Pyje me prall		268.3	94
	Nje kat	268.3	100
Pyje me ilqe		18.2	6
	Nje kat	18.2	100
	Totali i shtreses :	286.5	
	TOTALI I EKONOMISE :	4292	

Tabela VII.1.3.1 Katet e grumbullit në nivel eknomie.

VII.1.4 Cilësia e lëndës drusore në këmbë

Vlerësimi racional dhe kompleks i lëndës drusore kërkon njohuri të hollësishme të cilësisë së grumbujve pyjorë, jo vetëm në drejtim të volumit të përgjithshëm, por gjithashtu edhe në drejtim të vlerësimit të asortimenteve. Ky klasifikim është realizuar nga raporti i volumit të drurëve ekuivalentë me klasën e parë të cilësisë ndaj volumit të përgjithshëm. Kjo hipotezë vërtetohet kur kemi parasysh vetëm drurët e kategorisë së diametrave qendrorë, të cilët kanë peshën më të madhe në vëllimin e përgjithshëm të grumbujve pyjorë. Megjithatë nuk ka ndonjë vlerësim të cilësisë nga ekipet e inventarizimit në terren, në vlerësimin e cilësisë në bazohemi në raportin e lëndës së punimit dhe druve të zjarrit ndaj volumit të përgjithshëm.

VII.1.5 Biomasa dhe faktorët e ekspansionit të biomasës (BEF)

Grumbujt pyjorë të EP Papadhi Çipin, luajnë një rol të rëndësishëm në sekuestrimin e karbonit dhe si rezultat llogaritja e biomasës është e rëndësishme. Për llogaritjen e biomasës mbitokësore në përdorim të dhënave të volumit të siguruara nga inventarizimi në terren dhe për t'i konvertuar në peshë të thatë përdorim të dhënave të dendësisë nga Udhëzuesi i Panelit për Ndryshimet Klimatike (Panel for Climate Change) për speciet kryesore për regjimin e qeverisjes trungishte, cungishte dhe shkurre të cilat gjenden në të gjithë Ekonomisë Pyjore Papadhi Çipin, si në tabelën më poshtë:

Regjimi i qeverisjes	Sipërfaqja (ha)	Volumi mesatar (m ³ /ha)	Volumi i përgjithshëm në këmbë (m ³)
Trungishte	1310	119	156'361
Cungishte	1559	31	48'593
Shkurre	1423	3	4'668
Gjithsej	4292	49	209'622

- Panja, Bungëbuta, Bunga, Prralli dhe Ilqja për pyjet trungishte, llojet fletorë
- Bredhi i Maqedonisë dhe Pisha e Zezë për pyjet trungishte llojet halorë
- Prralli dhe Ilqja për pyjet cungishte
- Mare, prrall dhe ilqe për pyjet me formë qeverimi shkurre.

Përmbajtja e karbonit në peshën e thatë të biomasës u konsiderua 0.5. Konvertimi nga C në CO₂ u bë duke u bazuar në peshën molekulare (CO₂/C = 44/12 = 3.667).

Për llogaritjen e biomasës mbitokësore përdorim ekuacionin e mëposhtëm:

$$B_{mbt} = V_{total} \times Dd \times C_{ratio} \times BEF$$

ku:

V_{total} – volumi i përgjithshëm për secilin regjim qeverisje

D_d – dendësia e peshës së thatë

C_{ratio} – përmbajtja e karbonit në biomasën e thatë (0.5)

BEF_Faktori i ekspansionit të biomasës

Qeverisja	Sip. (ha)	Vol. (m ³)	Dendësia (Kg/m ³)	Peshe e thatë (ton)	BEF	Biomasë mbitokësore (ton)	Peshë e C (ton)	Pesha e CO ₂ (në ton)
Trungishte	1310	156'361	980	153'233	1.4	34'614'534	22'634	29'658
Cungishte	1559	48'593	720	34'987	1.4	8'713.808'	13'726	20'662
Shkurre	1423	4'668	810	3'781	1.4	1'245'924	8'186	9'349
Gjithsej	4292	209'622		4'546	1.4	44'574'266	44'546	59'669

Tabela VIII.1 Llogaritja e Biomasës mbitokësore dhe sasisë së karbonit të asimiluar në EP

Ashtu sikurse mund të vërehet edhe nga tabela e mësipërme, rezulton se EP Papadhi Çipin ka një biomasë mbitokësore prej afro 44.6 milion ton. Ndërsa pesha e karbonit rezulton të jetë 44.5 mijë ton dhe asimilon një sasi dioksidi karboni prej afo 60 mijë ton.

VII.1.6 Analiza e rolit të ekonomisë pyjore në sekuestrimin e Karbonit

Grumbujt pyjorë të EP Papadhi Çipin kanë një ekuivalencë të rezervës së karbonit prej 44.5 mijë ton dhe sekuestrim të dioksidit të karbonit prej afo 60 mijë ton. Kjo sasi i dedikohet pikë së pari formës së qeverimit, nga pyjet trungishte kopshtore të instaluar natyrisht në ekonomi, vijonë të kenë jo vetëm rezerva të konsiderueshme të karbonit, por të përthithin një sasi të konsiderueshme të CO₂. Po ashtu boniteti i stacionit sigurisht që ka rolin e vet në këtë drejtim. Në objektivat e këtij plani mbarështimi është planifikuar që të intensifikohet rritja e grumbujve dhe njëkohësisht nëpërmjet këtyre masave të synohet edhe konvertimi i grumbujve në një formë më të avancuar të qeverimit. Kjo do të çonte në rritjen e volumit të përgjithshëm të grumbujve të kësaj ekonomie, e rjedhimisht edhe në rritjen e sasisë së rezervave të karbonit dhe rritjen e sasisë së CO₂ të asimiluar (sekuestruar).

Ekzistenca e tregjeve të karbonit në të ardhmen mund të jetë një burim fitimi i konsiderueshëm për pronarët e këtij grumbulli pyjor.

VII.2 Gjendja shëndetësore/fitosanitare

Gjendja shëndetësore dhe fitosanitare e grumbujve pyjorë përgjithësisht vlerësohet të jetë e mirë. Në grumbujt pyjorë të kësaj prone **nuk ka shenja të ndikimeve masive të patogjenëve, të cilët zvogëlojnë rritjen apo çojnë deri në zhdukjen në nivel të grumbujve pyjorë.**

Megjithatë theksohet që **ka raste të vëzhgimeve të tharjes së drurëve për shkak të ndryshimeve klimatike dhe përsëritjes e zgjatjes së thatësirave, megjithëse grumbujt pyjorë do të ekspozohen veçanërisht në të ardhmen. Për rrjedhoja që lidhen me shfaqjen e zjarreve, EP ka humbur një numër të konsiderueshëm individësh, si pasojë e rritjes së temperaturave mesatare vjetore. Jo vetëm kaq, por pavarësisht frutifikimit të bollshëm të llojeve, asnjë nga pasarshtësit nuk arrin të mbijetojë kushteve ekstreme të thatësirës dhe uljes së ndjeshme të lagështirës ajrore.** Një rajon i tillë me të tilla fenomene vlen të studiohet dhe të konsiderohet, me synimin për të nisur me adaptimin e llojeve në funksion të ndryshimeve klimatike dhe efekteve negative që ato mund të kenë mbi grumbuj të caktuar.

VII.2.1 Drurët e tharë

Gjatë inventarizimit të grumbullit në terren, drurët e thatë i përkasin kryesisht kategorisë që lidhet me seleksionimin natyror dhe jo për shkaqe të tjera.

Në formën e qeverimit shkurre janë vërejtur individë të tharë të cilët lidhen me shkaqet e zjarreve të rëna gjatë viteve më parë në ekonomi.

Njëkohësisht efektet e ngrohjes globale duket se kanë impaktuar llojet halorë e veçanërisht bredhin e maqedonisë ku vërehet një rënie e numrit të popullatës të këtij lloji por ka edhe shenja të tharjes së majave të drurëve të këtij lloji e cila është shkaktari kryesor në uljen e ndjeshme të popullatës së tij.

VII.2.2 Dëmtime të tjera

Nuk janë vërejtur dëmtime të tjera gjatë punës në terren në të gjithë sipërfaqen pyjore në EP Papadhi Çipin

VII.3 Prerjet e paligjshme

VII.3.1 Prerjet e paligjshme, gjendja aktuale dhe efektet ne procesin e planifikimit

Siç është përmendur më sipër, prerjet e paligjshme jane prezente vetëm në afërsi të fshatrave të cila janë në afërsi të rrugës auto. Anës rrugës vërehen prerje, kryesisht të llojit prrall, bung, qarr, shkozë, mretë e mare, por jo në sasi që çënojnë vitalitetin dhe eksistencën e grumbullit të Ekonomise Pyjore Papadhi Çipin. **Më tepër se sa prerjet e paligjshme, janë prerjet informale që zhvillohen në të gjithë ekonominë pyjore.** Në këtë mënyrë, secila familje per te plotesuar nevojat e saj per dru zjarri ose per gardhe, hunj etj presin nje pjese te materialit drusor ne keto ngastrat pyjore.

Gjithsesi duhet të theksojmë se ky fenomen është drejt eliminimit të tij të plotë dhe nuk përbën asnjë shqetësim evident për Ep Papadhi Çipin.

VII.3.2 Impakti i prerjeve ilegale në planifikimin dhe mbarështimin e pyjeve

Siç është përmendur më sipër, prerjet e paligjshme jane prezente vetëm në afërsi të fshatrave të cila janë në afërsi të rrugës auto. Anës rrugës vërehen prerje, kryesisht të llojit bung, qarr, shkozë, mretë e mare, por jo në sasi që çënojnë vitalitetin dhe eksistencën e grumbullit të Ekonomise Pyjore Papadhi Çipin. **Më tepër se sa prerjet e paligjshme, janë prerjet informale që zhvillohen në të gjithë ekonominë pyjore.** Në këtë mënyrë, secila familje per te plotesuar nevojat e saj per dru zjarri ose per gardhe, hunj etj presin nje pjese te materialit drusor ne keto ngastrat pyjore.

Gjithsesi duhet të theksojmë se ky fenomen është drejt eliminimit të tij të plotë dhe uk përbën asnjë shqetësim evident për Ep Papadhi Çipin.

VII.4 Rezultatet e inventarizimit të kullotave

VII.4.1 Tipi dhe cilësia e kullotave

Ashtu si më sipër kemi theksuar, kullota në EP Papadhi Çipin shtrihet në vetëm 1252 ha. Sa i takon sipërfaqes kullosore, theksojmë se ajo është e pranishme thuajse përgjatë të gjithë ekonomisë pyjore. Ajo është pjeë përbërëse e saj dhe vendosët kryesisht në kurorën e ekonomisë. Përgjithësisht janë kullota të vendosura mbi formacione skeletike karbonike (gëlqerorësh) dhe ndikohen shumë shpejt nga thatësira dhe periodha pa reshje në stinën e verës. Gjatë

inventarizimit në terren verehet se kullotat shfytëzohen pak vetëm në stinën e pranverësh dhe gjatë verës apo vjeshtës nuk ka prezencë të bagëtisë. Kjo mbase për distancën e largët nga qendrat e banuara apo dhe humbjen e interesit të pupullsisë vendase për të mbarështuar bagëti. Sipas vendasve më parë kullota është shfrytëzuar me stane përgjatë periudhës Qershor-Tetor, por që pas viteve 1998, një traditë e tillë nuk ekziston. Ndërkohë që në qendër dhe në afërsi të vendeve ku janë ndërtuar stanet ekziston një lërë e cila është në gjendje të mirë aktualisht dhe ku është burimi i vetëm për ujëpirje për kafshët e egra që jetojnë në këtë lloj rrafshnalte të izoluar.

Habitati I ketyre kullotave konsiderohet mjaft i pasur me lloje të cilat dominohen nga shoqërimet me: *Poa media-Festucetum panciana*, *Cynosuro-Trifolietum pratense*, *Phleum alpinum-Koeleretum splendens* dhe *Asphodeletum albus-Narcissus poeticus*.

Llojet treguese të tij janë: *Campanula glomerata*, *Carex spp.*, *Carex viridula*, *Centaurea jacea*, *Crocus veluchensis*, *Fritillaria macedonica*, *Hieracium cymosum agg.*, *Taraxacum officinale*, *Trifolium repens*, *Viola aetiolica* and *Anthoxanthum odoratum*, *Koleria pyramidata*, *Sesleria comosa*, *Trisetum flavescens* etj.

Gjithsesi duhet theksuar që këta kullota më shumë se të lëna pas dore për arsye të shërbimeve që duhet të kryeshin nëto, aktualisht ato kanë humbur interesin e komunitetit duke bërë që ato të mos frekuentohen prej vitesh. Kjo ka sjellë si pasojë jo vetëm uljen e sipërfaqes si pasojë e ekspansionit pyjor në drejtim të tyre, por edhe prishjen e cilësisë së tyre.

